

PERMBAJTJA

	Fq.
KUPTIMI DHE PERMBAJTJA E BILANCIT TE PAGESAVE	2
KLASIFIKIMI	10
MALLRAT	15
SHERBIMET	22
TE ARDHURAT	28
TRANSFERTAT KORRENTE DHE KAPITALE	31
INVESTIMI DIREKT	37
INVESTIMET E PORTOFOLIT	38
INVESTIME TE TJERA	47
MJETET E REZERVES	50

KUPTIMI DHE PERMBAJTJA E BILANCIT TE PAGESAVE

Parathenie.

1.1 Ky kapitull sqaron konceptet baze dhe strukturen e bilancit te pagesave. Fillon me perkufizimin e bilancit te pagesave duke theksuar ne menyre te permbledhur disa prej faktoreve qe influencojne ne strukturen dhe permbytjen e tij. Vazhdon me parimet kryesore mbi te cilat ngrihet bilanci i pagesave, si sistemi i rregjistrimit te dyfishte, rezidenca, vleresimi, koha e rregjistrimit, etj. Se fundi, pershkruan transaksionet kryesore ekonomike dhe ndryshimet e tjera qe rregjistrohen ne bilancin e pagesave dhe permbledh disa nga problemet qe lidhen me paraqitjen e statistikave te bilancit te pagesave.

Cfare eshte bilanci i pagesave?

1.2 **Bilanci i pagesave eshte nje pasqyre statistikore qe permbledh ne menyre sistematike, per nje periudhe te caktuar kohe, transaksionet ekonomike te nje vendi me boten qe e rrethon.** Keto transaksione, qe ne shumicen e rasteve ndodhin midis rezidenteve e jorezidenteve, nenkuptojne veprime ekonomike, qe mund te klasifikohen ne tre kategori te medha. *Kategoria e pare* perfshin transaksionet ne mallra, sherbime dhe te ardhura midis rezidenteve dhe jorezidenteve. *Kategoria e dyte* perfshin transaksionet financiare, qe perfaqesojne pretendimet dhe detyrimet e rezidenteve ndaj jorezidenteve. *Kategoria e trete* i referohet zerave balancues per hir te *sistemit te rregjistrimit te dyfishte*. Ky sistem kerkon, qe ne raste transaksionesh te tilla si ndihmat, qe nga natyra jane transaksione te njeanshme ose pa shperblim, te krijohet nje ze "fiktiv" balancues per te ruajtur ekuilibrin midis shumesh debive e kredive. Tradicionalisht, kategoria e pare dhe e trete e transaksioneve kombinohen ne te ashtequajturen Llogari Korrente, ndersa kategoria e dyte paraqitet vecazi ne Llogarine Kapitale e Financiare.

1.3 Vete transaksioni, percaktohet si nje fluks ekonomik qe pasqyron krijimin, transformimin, shkembimin, transferimin ose shuarjen e nje vlere ekonomike dhe nenkupton ndryshimin e pronesise mbi mallrat dhe/ose mjetet financiare, kryerjen e sherbimeve, ose sigurimin e fuqise punetore dhe kapitalit.

1.4 Megjithate, ky percaktim nuk eshte vecse nje pershkrim i thjeshte i bilancit te pagesave. Si i tille, ai eshte subjekt i nje sere "harresash" e perjashtimesh te rasteve te vecanta. Permendim ketu ndryshime qe nuk lindin nga transaksione ekonomike dhe disa transaksione midis vete rezidenteve apo vete jorezidenteve, te cilat gjithashtu rregjistrohen ne kete bilanc per ta bere ate me te vlefshem per qellime analize.

Ne fakt edhe vete termi *Bilanc Pagesash* nuk eshte mjaft i pershtatshem. Perse ky emer nuk i shkon pershtat "bilancit tone"? Emri Bilanc Pagesash te jep te kuptosh qe behet fjale vetem per transaksione qe shoqerohen me pagesa ose arketime. Ne fakt, kuptimi dhe sfera e veprimtarise se tij eshte shume me e gjere dhe perfshin edhe veprime ekonomike, tek te cilat transaksioni dhe

likuidimi monetar jane te shkeputura ne kohe. Po ashtu, ky bilanc trajton edhe transaksione qe nuk nenkuptojne asnje lloj likuidimi monetar si p.sh. ndihma, shkembime mallrash mes njesive ekonomike te ndervarura, etj. Gjenezja e bilancit te pagesave eshte e lidhur ngushte me kontrollin valutore, bile mund te thuhet qe ne fazat e tij fillestare bilanci i pagesave ishte vetem nje apendiks i kontrollit te kembimeve valutore. Arsyeja e vertete pra, perse ky term nuk zevendesohet jane rrenjet e thella ne te kaluaren dhe perdorimi i tij masiv edhe ne kohet moderne.

1.5 Nje arsye tjeter perse ky term nuk eshte i pershtatshem eshte se ai te krijon idene e nje bilanci te vetem, ose te nje serie bilancesh. Ne realitet, bilanci i pagesave eshte nje **sistem llogarish**, te cilat do te trajtohen me hollesisht ne kapitullin e dyte.

Konteksti statistikor

1.6 E rendesishme eshte te kihet parasysh jo vetem ajo cka bilanci i pagesave duhet te regjistroje, por edhe vlerat e tij te perdorimit, ne kete pike duhet theksuar fakti qe qellimi primar i bilancit te pagesave eshte te lehtesoje analizen e pasojave te transaksioneve dhe ndryshimeve te tjera ne ekonomine e nje vendi.

1.7 Konceptet baze te perdorura kane si qellim primar t'u pershtaten kerkesave te perdoruesve shqiptare. Fakti qe bilanci i pagesave eshte pjese organike e Sistemit te Llogarive Kombetare (S.L.L.K.) shpjegon perse ky bilanc perdor ne nje shkalle te gjere koncepte dhe perkufizime te ngjashme me ato te perdorura ne S.L.L.K.

1.8 Bilanci i pagesave paraqet gjithashtu interes per komunitetin nderkombetar per faktin se ai reflekton transaksionet e nje vendi me "boten". Ne rreshtin e perdoruesve nderkombetar pervec partnereve kryesore perfshihen edhe organizatat nderkombetare, vecanerisht ato ku vendi ne fjale ben pjese. Pikerisht per kete interes kombetar e nderkombetar qe ngjall bilanci i pagesave, eshte e rendesishme qe te sigurohet nje ngjashmeri ne termat e konceptet e perdorura, ne formen e prezantimit dhe ne ndertimin e tij. Per te siguruar kete ngjashmeri dhe per te siguruar nje udhezues ne ndihme te vendeve antare te tij, Fondi Monetar Nderkombetar ka hartuar Manualin e Bilancit te Pagesave, edicioni i pare i te cilit eshte botuar ne 1948 dhe ai i fundit (i pesti) ne 1993. Konceptet baze dhe struktura e klasifikimit te bilancit te pagesave te Shqiperise mbesheten teresisht mbi edicionin e peste te manualit te Fondi Monetar Nderkombetar.

1.9 Ndertimi i bilancit te pagesave konsiston ne nje sere parimesh dhe konceptesh baze te krijuara per te lehtesuar rregjistrimin sistematik dhe uniform te transaksioneve ekonomike dhe te ndryshimeve te tjera qe perfshihen ne bilancin e pagesave. Parimi me kryesor eshte aplikimi i sistemit te rregjistrimit te dyfishte. Po ashtu, permenden edhe konvencionet per dallimin e njesive rezidente nga ato jorezidente. Parime uniforme perdoren edhe per vleresimin dhe kohen e rregjistrimit te transaksioneve qe rregjistrohen ne kete bilanc. Megjithate, ne praktike, si pasoje e kufizimeve ne burimet e informacionit, rregjistrimi i transaksioneve ne vleren dhe ne kohen e duhur nuk eshte gjithmone i mundur.

Rregjistrimi i dyfishte

1.10 Sipas sistemit te rregjistrimit te dyfishte, cdo transaksion duhet te figuroje ne dy rregjistrime me vlere te njejte, njeri prej te cileve eshte ne kredi (me shenje pozitive) dhe tjetri ne debi (me shenje negative). Ne parim, shuma absolute e gjithe rregjistrimeve ne kredi duhet te jete

aritmetikisht e barabarte me shumën e rregjistrimeve në debi dhe si rrjedhim shuma neto e të gjitha rregjistrimeve të bilancit del zero.

1.11 Në praktike shpesh informacioni sigurohet nga burime të ndryshme dhe kur nuk disponohen të dhëna aplikohen edhe vlerësime. Pra shuma e kredive me debite mund të rezultojë në një shumë neto kreditore ose debitore. Pikerisht për të "balancuar" bilancin kjo shumë vendoset artificialisht me shenjë të kundërt në zerin "**Gabime dhe Harresa Neto**". Megjithatë, ky ze kursesi nuk mund të shërbejë si një tregues i sakte i cilesisë, ose i besueshmërisë së një bilanci pagesash dhe kjo për faktin se gjatë rregjistrimit mund të kemi si harresa (transaksione që nuk janë përfshirë në bilanc), ashtu dhe transaksione të mbivleresuara (të dy anët e bilancit janë mbivlerësuar në të njëjtën masë). Pra zeri "Gabime dhe Harresa Neto" nuk do të prekej aspak nga gabimet në fjale.

1.12 Sipas sistemit të rregjistrimit të dyfishtë në **kredi** rregjistrohet: i. eksporti i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat e arketueshme (të ardhura aktive), ii. zera financiare që përfaqësojnë një reduktim në mjetet e huaja financiare të një vendi, ose një rritje në detyrimet e huaja të tij. Në të njëjtën mënyrë, rregjistrohet në **debi** i. importi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat e pagueshme (të ardhura pasive), ii. dhe transaksione që përfaqësojnë një rritje në mjetet e huaja financiare ose një reduktim të detyrimeve të huaja. Në këtë sistem rregjistrimit shfaqen në çift debitimesh dhe kreditimesh të barabarta. Për shembull, një transaksion eksporti, pagesa e të cilit bëhet nepermjet sistemit bankar, sjell një rregjistrim në kredi për eksportin dhe një rregjistrim në debi për rritjen e mjeteve valutore. Në mënyrë të ngjashme, shlyerja e një huaje nepermjet sistemit bankar nënkupton një rregjistrim në debi për reduktimin e detyrimeve dhe një rregjistrim në kredi për pakesimin e mjeteve valutore.

1.13 Ato transaksione që nuk mund të ciftezohen automatikisht, kërkojnë futjen e një zeri të vecantë balancues. Një ze i tillë është i nevojshëm për kategorinë e transfertave të njëanshme që nuk janë gjë tjetër veçse ndihma materiale e financiare që një vend përfiton nga një tjetër. P.sh. një ndihmë ushqimore për Shqipërinë nga jashtë do të implikonte një debitim në kategorinë **Mallra** (d.m.th. import) dhe një kreditim në zerin *transferta pa shpërblim*.

Rezidentet

1.14 Bilanci i pagesave trajton transaksionet e një vendi (rezidentëve) me "Botën" (jorezidentët). Pra, është e nevojshme të përcaktohet një kufi ndares ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve të një ekonomie. Si "masë" për përcaktimin e rezidencës përdoren konceptet e *territorit ekonomik* dhe të *qendres së interesit ekonomik*.

1.15 Një njësi institucionale konsiderohet rezidente e një vendi kur qendra e saj e interesit ekonomik **bie** në territorin ekonomik të këtij vendi.

Territori ekonomik i një vendi konsiston në territorin gjeografik të administruar nga qeveria e këtij vendi, brenda të cilit personat, mallrat dhe kapitalet qarkullojnë lirisht. Territori ekonomik mund të mos përputhet gjithmone me atë gjeografik.

Një njësi ka një **Qender të Interesit Ekonomik** brenda një vendi kur ajo ka një seli, vend prodhimi, ose premisa të tjera brenda territorit ekonomik të këtij vendi, në të cilin ajo angazhohet në aktivitete dhe transaksione ekonomike në një shkallë të konsiderueshme, për një periudhë të papërcaktuar kohe, ose për një periudhë të përcaktuar, por të gjatë kohe.

1.16 Rezidentet e nje ekonomie ndahen ne keto njesi institucionale:

- Institucionet qeveritare
- Ndermarrjet
- Institucionet jo fitimprures
- Individet

1.17 *Institucionet qeveritare* perbehen nga autoritetet qeveritare shtetore dhe lokale, ambasadat, konsullatat, zonat ushtarake dhe njesite e tjera qeveritare jashte kufijve gjeografike. Ne menyre te ngjashme njesite institucionale te vendeve te tjera te vendosura brenda territorit ekonomik te nje vendi trajtohen si jorezidente.

1.18 *Ndermarrjet* perfshijne te gjitha njesite ekonomike te angazhuara ne prodhimin e mallrave dhe sherbimeve mbi baza komerciale brenda territorit ekonomik te nje vendi. Keto ndermarrje mund te jene private ose shtetore, me pronar vendas ose te huaj.

1.19 *Njesite pa qellim fitimi* rezidente jane ato, ne te cilat individet/ndermarrjet koeprojne si pronare, per prodhimin e mallrave dhe sherbimeve brenda territorit ekonomik te nje vendi, me qellime te tjera nga ai i fitimit. Shembuj te ketyre njesive jane kisha, Kryqi i Kuq, organizatat bamirese qe sigurojne ndihma per nevojtares, si dhe perfaqesi biznesi te tilla si dhoma e tregtise etj.

1.20 *Individe* rezidente konsiderohen te gjitha ata persona qe banojne ne territorin ekonomik te nje vendi, pervec personave qe ndodhen aty perkohesisht. Perjashtim bejne ata persona qe megjithese ndodhen jashte, qendren e interesit ekonomik e kane ne vendin e tyre te origjines. Ketu perfshihen punonjesit e ambasadave, anetaret e forcave te armatosura dhe nenpunesit e tjere qe ndodhen jashte kufijve. Anasjelltas diplomatet, ushtaraket, qeveritaret dhe studentet e huaj ne kete vend konsiderohen rezidente te vendeve qe perfaqsojne. Ne Manual rekomandohet qe personat te cilet qendrojne ne nje vend per nje periudhe me te gjate se nje vit, do te konsiderohen rezidente te ketij vendi.

Raste te vecanta

(a) *Paisjet e levizeshme.*

1.21 Transaksionet nderkombetare shoqerohen me perdorimin e mjeteve te levizeshme (sic jane, anijet, aeroplanet, platformat naftenxjerrrese, etj) te cilat kane nevojte per konsiderata te vecanta lidhur me konceptin e rezidences. Keto mjete dallohen prej mjeteve te tjera vetem nga fakti se ne nje periudhe te caktuar kohe, ato mund te perdoren per te kryer sherbime ne territoret e vendeve te ndryshme, ose mund te operojne ne hapsirat nderkombetare. Si rrjedhim natyra e ketyre mjeteve shkakton veshtiresi ne percaktimin e rezidences se tyre.

1.22 Per te shmangur konfuzionin e shkaktuar nga rastet e trajtuara me lart, pranohet nje rregull shtese, sipas se cilit: paisjet e levizeshme qe veprojne ne me shume se ne nje territor gjate nje viti, ose ne hapsirat nderkombetare ne praktike me ndonje perjashtim do t'i atribuohet rezidenca e ndermarrjes qe i zoteron keto mjete. Perjashtimet i referohen rasteve kur paisjet jane subjekte te nje marreveshjeje te perkohshme "carter" ose te nje lizingu financiar. Ne keto raste

natyres se transaksionit i jepet precedence ndaj formes se tij legale, si rrjedhim ketyre mjeteve i atribuohet rezidenca e carteruesit ose qiramarrsit.

(b) Toka, mjete te tjera te palevizshme dhe mjetet jofinanciare-jofizike.

1.23 Marreveshja e bere ne Manualin e Fondi Monetar Nderkombetar mbi token, pranon si pronare te vetem te saj rezidentet e ekonomise se ciles ajo i perket. Keshtu, toka qe ne fakt zoterohet nga nje i huaj, trajtohet sikur te jete prone e nje ndermarrjeje rezidente, e cila nga ana e saj ka nje detyrim ndaj pronarit real te tokes. I njejti trajtim u behet dhe paisjeve te palevizshme (pervec srukturave te zoteruara nga njesite qeveritare te huaja) dhe mjeteve jofinanciare-jofizike te akorduara nga qeverite e huaja (p.sh. e drejta e autorit, patentat dhe licensat etj).

(c) Organizatat nderkombetare.

1.24 Organizatat nderkombetare qe ndodhen brenda territorit ekonomik te nje vendi dhe qe nuk klasifikohen si ndermarrje financiare ose tregtare, trajtohen si jorezidente. Ne dallim me kete trajtim, organizatat nderkombetare te cilat angazhohen ne prodhimin e mallrave e sherbimeve trajtohen ne te njejten menyre si ndermarrjet e tjera financiare e tregtare.

Vleresimi

1.25 Ekzistojne shume arsye qe e bejne te domosdoshem perdorimin e nje parimi uniform vleresimi per te gjithë transaksionet e bilancit te pagesave. Ne rradhe te pare, shuma e gjithë rregjistrimeve ne debi dhe ne kredi ne nje bilanc nuk do te ishte e barabarte ne qofte se kedia dhe debia e nje transaksioni te cilat ne praktike mund te sigurohen nga burime te pavarura nuk vleresohen me te njejtin cmim. Per me teper, bilancet e vendeve te ndryshme nuk do te ishin te krahasueshme ne qofte se te dy palet pjesemarrrese ne transaksion nuk do te adoptonin te njejtin parim vleresimi.

Ne Manual rekomandohet, qe si njesi uniforme per vleresimin e transaksioneve te bilancit te pagesave te perdoret *cmimi i tregut*. Ky cmim perkufizohet si: **"Shuma e parave qe nje bleres i vullnetshem paguan per te blere dicka nga nje shites i vullnetshem, kur ne kete kembim te dy palet i nenshtrohen vetem konsideratave tregtare"**.

1.26 Ne pjesen me te madhe, cmimi me te cilin eshte rregjistruar nje transaksion ne llogarite e transaktoreve ose ne raportet tregtare te perdorura si burim te dhenash, eshte *cmimi i tregut* ose nje perafirim i ngushte i tij. Ky vleresim njihet si *cmim transaksioni* dhe praktikisht perdoret si vleresim per shkak te perafersise se tij me vleresimin ideal te tregut.

1.27 Ne rastet e transfertave, ose ne marredheniet e huamarrjes ndermjet ndermarrjeve te ndervarura, mund te ndodhe qe per shkak te lidhjeve te tyre te vecanta, keto transaksione te vleresohen me cmime te ndryshme nga ato te tregut. Keto raste perbejne nje dallim nga parimi i cmimit te tregut.

1.28 Per aq kohe sa do te shihet e arsyeshme, transaksionet ne bilancin e pagesave te Shqiperise do te paraqiten te vlersuara ne USD. Ky vleresim, kerkon konvertimin ne USD e te gjitha transaksioneve te vlersuara ne lek ose ne monedha te tjera, me kursin e tregut ne momentin e kryerjes se transaksionit.

Ne praktike kursi aktual i perdorur varion lidhur me burimin e te dhenave te transaksionit dhe praktikat e rregjistrimit.

Koha e rregjistrimit

1.29 Eshte shume e rendesishme qe dy anet e nje transaksioni, i cili mund te vleresohet duke perdorur burime te ndryshme te dhenash, te rregjistrohen ne bilancin e pagesave ne te njejten kohe. Ne te njejten menyre llojet e ndryshme te transaksioneve, duhet te rregjistrohen duke perdorur nje koncept te qendrueshem dhe uniform mbi kohen e rregjistrimit.

1.30 Sipas rekomandimeve te Manualit te fundit te Fondi Monetar Nderkombetar, ne metodiken tone te bilancit te pagesave si kohe e rregjistrimi te transaksioneve pranohet **momenti i ndryshimit te pronesisë**. Sipas ketij parimi, rregjistrimi i transaksioneve ne llogarine korrente behet ne momentin e:

- ndryshimit te pronesisë legale mbi mallrat
- kryerjes se sherbimeve
- gjenerimit (krijimit) te fitimeve te riinvestuara qe u takojne investitoreve direkte
- maturimit te interesave dhe dividendeve

Ne rastin e transfertave pa shperblim, si taksat dhe penalitete te tjera, rregjistrimi do te behet ne momentin e maturimit te tyre (ne momentin qe ato duhen paguar); ndersa per transfertat e tjera, rregjistrimi kryhet ne momentin kur: mallrat-ndihma nderrojne pronesi, sherbimet-ndihma kryhen, etj.

1.31 Per transaksionet e llogarise kapitale, si moment i kalimit te pronesisë eshte pranuar me marreveshje koha e rregjistrimit te transaksioneve ne librat e transaktoreve. Keshtu, rregjistrimet ne rastin e terheqjes se nje huaje, duhet te bazohen ne disbursimin aktual dhe jo ne marreveshjen apo autorizimin e saj, ndersa rregjistrimet per ripagimin e huase duhet te behen ne momentin kur ato maturohen dhe jo ne daten aktuale te pagimit.

1.32 Ekzistojne dy raste te vecanta ne te cilat nuk ndodh nje kalim legal i pronesisë, por megjithate ne keto raste ky ndryshim pronesisë supozohet sikur te kete ndodhur dhe transaksionet rregjistrohen.

(a) Mallrat ne lizing financiar.

Si moment i *ndryshimit te pronesisë* konsiderohet momenti i livrimit te mallrave nga qiradhenesi tek qiramarresi.

(b) Transaksionet ndermjet nje dege dhe kompanise se huaj meme.

Keto transaksione duhet te rregjistrohen ne momentin kur ato pasqyrohen ne librat e deges dhe te kompanise meme. Ne praktike ky moment mund te mos koincidoje me rregjistrimin e transaksionit tregtar, qe ka si burim te dhenash hyrjet e eksport-importit te perpunuara nga Sherbimi Doganor.

Koncepti dhe llojet e transaksioneve ekonomike.

1.33 Pavaresisht nga emri i tij, bilanci i pagesave nuk trajton vetem ato transaksione qe nenkuptojne pagesa, por transaksionet ekonomike ne pergjithesi. Nje transaksion ekonomik (ose thjesht nje transaksion), ndeshet atehere kur nje vlere ekonomike nderron pronesine. Gjithashtu, ne nje sistem llogarish me rregjistrim te dyfishte sic eshte dhe bilanci i pagesave, cdo transaksion i rregjistruar duhet ti kete te dy aspektet, si kredine ashtu dhe debine. Ne bilancin e pagesave me termin transaksion do te kuptojme shpesh dhe transaksione qe ne praktike kane vetem njerin prej ketyre aspekteve (rasti i transfertave pa shperblim).

1.34 Transaksionet e rregjistruara ne bilancin e pagesave rrjedhin kryesisht nga bashkeveprimi i dy paleve, njera prej te cilave eshte rezidente dhe tjetra jorezidente. Duhet theksuar megjithate, se palet pjesmarrese ne transaksionet ne **detyrimet dhe mjetet e huaja financiare**, mund te jene te dyja rezidente ose te dyja jorezidente. Keto transaksione do te paraqiten ne bilancin e pagesave vetem ne qofte se ato sjellin transferim te pretendimeve ose te detyrimeve ndermjet paleve te *trajtuara ndryshe statistikisht*.

1.35 Paragrafet e meposhtem pershkruajne llojet e ndryshme te transaksioneve dhe ndryshimeve te tjera qe perfshihen ne bilancin e pagesave.

(a) Shkembimet

1.36 Shkembimet mund te konsiderohen si transaksionet me te rendesishme e me numeroze te bilancit te pagesave. Ne kete grup perfshihen te gjitha ato transaksione ku njera pale i siguron nje vlere ekonomike pales tjetere dhe merr ne kthim nje vlere te barabarte. Keto vlere ekonomike kategorizohen kryesisht ne burime reale (mallra, sherbime, te ardhura) dhe zera financiare. Palet pjesemarrese ne nje transaksion te tille jane rezidente te ekonomive te ndryshme, me perjashtim te rastit te shkembimit te mjeteve te huaja financiare ndermjet sektoreve rezidente te se njejtës ekonomie.

(b) Transfertat

(i) Transfertat pa shperblim

1.37 Transaksionet ne transfertat ndryshojne nga shkembimet sepse ne keto transaksione njera pale i jep nje vlere ekonomike pales tjetere por nuk merr ne kthim nje vlere te njejte. Kjo vlere ekonomike qe mungon ne njerën ane te transaksionit shfaqet ne bilanc nepermjet nje rregjistrimi ne zerin Transferta, duke i qendruar besnik sistemit te rregjistrimit te dyfishte.

(ii) Transfertat e migranteve

1.38 Transfertat e migranteve paraqesin nje tip te vecante te transfertave pa shperblim. Shembulli i nje migranti, qe ndryshon gjendjen e tij nga jorezident ne rezident (dhe anasjelltas) eshte subjekt i nje trajtimi te vecante statistikor.

1.39 Migrimi ndeshet kur rezidenca e nje individi kalon nga nje ekonomi ne nje tjetër, për arsye se ky individ ndryshon vendbanimin e tij. Kur ndodh ky ndryshim, prona e zotëruar nga migranti në ekonomine e vjetër (vendin e tij të origjinës), kthehet në një pretendim të ekonomisë së re ndaj ekonomisë së vjetër. Pretendimet dhe detyrimet e migrantit ndaj rezidentëve të një ekonomie, përveç asaj të re, shndërrohen në pretendime dhe detyrime të ekonomisë së re. Pretendimet dhe detyrimet e migrantit ndaj rezidentëve të ekonomisë së re, kthehen në pretendime dhe detyrime ndërmjet rezidentëve të së njëjtes ekonomie. Vlera neto e ndryshimeve të përmendura më lartë, me marrëveshje rregjistrohet në transfertat e njëanshme. Teorikisht këto transaksione përfshijnë pronën, detyrimet dhe pretendimet e migrantëve, por në praktikë preferohet të rregjistrohen vetëm transfertat në kesh. Keshi i sjellë nga një person i cili ka ndryshuar vendin e tij të rezidencës rregjistrohet si një rritje e vlerës të huaj (debi) dhe si një transfertë e njëanshme (kredi).

(c) Transaksione të simuluar

1.40 Në disa raste transaksionet mund të simulohen edhe pse nuk ndeshen flukse reale të mirash. Një rast tipik është ai i fitimeve të riinvestuara në ndërmarrjet e investimit direkt¹, për fitimet që u takojnë investitorëve të huaj. Fitimet e riinvestuara rregjistrohen si një komponent i të **ardhurave** nga investimet e huaja direkte, njëkohësisht një rregjistrim balancues me shenjë të kundërt behet në **llogarinë financiare** në **zerin investime direkte** për të reflektuar rritjen në vlerën e investimit të investitorit direkt në ndërmarrje.

(d) Riklasifikimi i pretendimeve dhe detyrimeve

1.41 Skema e klasifikimit që është adoptuar në llogarinë kapitale të bilancit të pagesave nënvizon karakteristikat që reflektojnë qëllimin e investitorit. Ky qëllim mund të ndryshojë përgjatë kohës, duke ndikuar karakterin e investimit dhe që këtë klasifikimin e tij. Për shembull, disa aksionistë të pavarur që zotërojnë investime portofoli të një ndërmarrjeje jorezidente, mund të bashkojnë kapitalet e tyre duke formuar një grup, duke synuar të kenë një zë efektiv në drejtimin e ndërmarrjes. Kapitali i tyre i bashkuar do të përmbushi kriterin e një investimi direkt, dhe ndryshimi në statusin e investimit do të rregjistrohet si një riklasifikim. Riklasifikimi duhet të reflektohet në fund të periudhës kur ka ndodhur në pozicionin e investimeve ndërkombëtare por jo në bilancin e pagesave. Shembull tjetër është ai i monetarizimit dhe cmonetarizimit të arit.

1.42 Ari trajtohet në një mënyrë të veçantë në bilancin e pagesave. Ai konsiderohet si një mjet financiar kur zotërohet nga autoritetet qendrore si pjesë e rezervës kombëtare. Në këtë rast ai quhet ar monetar.

Ari hyn në mjetet jomonetare kur trajtohet si një mall i zakonshëm i zotëruar nga çdo njësi ose individ, duke përfshirë këtu dhe autoritetet qendrore. Dhe në këtë rast quhet ar jomonetar.

1.43 Riklasifikimi i arit nga jomonetar në monetar quhet monetarizim. Kjo ndodh nëse autoritetet monetare rrisin zotërimet e tyre në mjete të rezervës shtetërore, duke fituar ar

¹. Një ndërmarrje investimi direkt është një ndërmarrje ku një ose disa investitorë jorezidentë zotërojnë më shumë se 10% të aksioneve votuese.

jomonetar nga nje rezident ose nga nje jorezident, ose nga riklasifikimi i arit qe ato zoterojne nga mjete reale ne mjete financiare.

Riklasifikimi i anasjellte i arit, nga ar monetar ne jomonetar quhet cmonetarizim. Kjo ndodh, nese autoritetet monetare nxjerrin (perdorin) arin monetar te zoteruar prej tyre per qellime jomonetare. Ndryshimet ne rezervat e arit monetar te shkaktuara nga monetarizimi apo cmonetarizimi i tij nuk reflektohen ne bilancin e pagesave.

Ndryshimet nga rivleresimi

1.44 Vlerat e mjeteve reale dhe zerave financiare jane subjekt i ndryshimeve te vazhdueshme per njerin nga dy shkaqet e meposhtme: i. nje ndryshim ne cmimin me te cilin vleresohet nje mjet real ose nje ze financiar dhe ii. nje ndryshim ne kursin e kembimit midis monedhes vendase dhe monedhes ne te cilen vleresohen mjetet reale dhe zerat financiare. Ndryshimet nga rivleresimi nuk paraqiten ne bilancin e pagesave.

KLASIFIKIMI

Hyrje

2.1 Sikurse permendet edhe me lart, bilanci i pagesave perfshin gjithe transaksionet qe ndodhin ndermjet rezidenteve dhe jorezidenteve. E pra, perpunimi eficient i ketij informacioni kaq te gjere, e te mbledhur nga burime te ndryshme, eshte i pamundur pa organizimin e ketyre te dhenave statistikore, ne disa kategori te pershtatshme per analizat ekonomike. Pikerisht,

organizimi i ketij informacioni statistikor ne nje format te zgjedhur, konsiderohet si klasifikim i bilancit te pagesave. Te dhenat mund te paraqiten ne me shume se nje klasifikim, ashtu sikurse nje klasifikim mund te perdoret vetem per nje pjese te te dhenave. Kjo behet me qellim qe te lehtesohet perdorimi dhe adaptimi i tyre per qellime te ndryshme sic jane hartimi i politikave makroekonomike, studime analitike, parashikime, krahasime te ndryshme, etj.

Ne kete kapitull pershkruhet klasifikimi i perdorur ne Bilancin Shqiptar te Pagesave.

Llogaria korrente/kapitale

2.2 Klasifikimi me themelor i aplikuar ne bilancin e pagesave eshte grupimi i te dhenave ne llogarine korrente dhe ne llogarine kapitale e financiare. Perfshirja e transaksioneve te vecanta ne njerin apo ne tjetren llogari eshte deri diku edhe ceshtje tradicionale. Megjithate, ne pergjithesi, llogaria korrente perfshin ato transaksione qe jane te pakthyeshme pasi kane ndodhur, ndersa llogaria kapitale e financiare rregjistron transaksionet ne detyrimet dhe mjetet e huaja financiare te nje ekonomie, te cilat nga natyra e tyre, jane te kthyeshme .

Llogaria korrente

2.3 Llogaria korrente mbulon te gjitha transaksionet ndermjet rezidenteve dhe jorezidenteve te Shqiperise ne mallra, sherbime, te ardhura dhe transferta te njeanshme. Secila prej ketyre kategorive pershkruhet me hollesisht ne vijim.

(a) Mallrat (sipas bilancit te pagesave)

2.4 Kjo kategori mbulon *mallrat* e levizshme (me disa perjashtime), pronesia e te cilave kalon nga rezidentet tek jorezidentet (eksportet) dhe anasjelltas nga jorezidentet tek rezidentet (importet).

(b) Sherbimet...

2.5 mbulojne *sherbimet* e kryera nga rezidentet per jorezidentet (kredi) dhe nga jorezidentet per rezidentet (debi). Ne kete kategori perfshihen gjithashtu nje pakice transaksionesh ne mallra, te cilat nuk eshte praktike te ndahen nga sherbimet qe i shoqerojne keto mallra (p.sh. mallrat e blera nga turistet). Sherbimet me tej ndahen ne grupet e meposhtme:

- sherbime transporti
- sherbime sigurimi
- udhetim
- sherbime te tjera.

(c) Te ardhurat...

2.6 mbulojne *te ardhurat* qe rezidentet fitojne nga jorezidentet (kredi), ose qe jorezidentet fitojne nga rezidentet (debi). Ky ze ndahet me tej si vijon ne:

1. Te ardhura nga puna
2. Te ardhura nga investimet

(d) Transfertat korrente¹

2.7 *Transfertat korrente*, jane rregjistrime balancuese qe aplikohen ne rastet e ndryshimeve te pronesise se vlerave reale (mallra apo sherbime) nga rezidentet tek jorezidentet (debi), ose nga jorezidentet tek rezidentet (kredi), te cilat nuk shoqerohen me shperblim nga pala tjeter. Transfertat korrente klasifikohen ne:

1. Ndhima shteterore nga jashte
2. Dergesa nga te catdhesuarit
3. Te tjera

Llogaria kapitale dhe financiare

2.8 Llogaria kapitale dhe financiare ndahet ne llogarine kapitale dhe ne llogarine financiare. **Llogaria Kapitale** teorikisht mbulon *Transfertat Kapitale* dhe Transaksionet ne Mjete Jofizike Jofinanciare.

Transfertat kapitale i referohen atyre rregjistrimeve balancuse qe aplikohen ne rastet e ndryshimeve te pronesise se **vlerave financiare** nga rezidentet tek jorezidentet (debi), ose nga jorezidentet tek rezidentet (kredi), te cilat nuk shoqerohen me shperblim nga pala tjeter.

Llogaria Financiare mbulon transaksionet ne mjetet dhe detyrimet e huaja te Shqiperise. Keto rregjistrime klasifikohen sipas kriterëve te meposhteme:

- drejtimi i investimeve
- instrumenti i investimit

Kategorite kryesore te llogarise financiare, perkatesisht *Detyrime* dhe *Mjete*, tregojne drejtimin, ose me mire kahun e investimeve. Tek detyrimet, p.sh. zeri *Investime Kapitale* i referohet investimeve te huaja ne Shqiperi, ndersa tek mjetet, po ky ze, i referohet investimeve shqiptare jashte shtetit. Ne pergjithesi, nen zerin *Detyrime* klasifikohen influkset e kapitalit ne Shqiperi, ndersa nen zerin *Mjete* klasifikohen outflukset e kapitalit nga Shqiperia.

Ne llogarine financiare, nen zerat kryesore te mjeteve e detyrimeve, flukset e kapitalit klasifikohen me tej sipas instrumentit te investimit si depozita, kredi tregtare, etj.

Rezervat

2.9 Qe nga periudha e standartit te arit (Breton Wood), kur vemendja drejtohej kryesisht nga ari monetar, e deri ne ditet e sotme, kur kjo vemendje eshte shmangur ne drejtim te nje sere

¹ Ne edicionin e katert te Manualit te Bilancit te Pagesave 1977, te gjitha transfertat klasifikohen ne llogarine korrente. Ne edicionin e fundit ato ndahen ne transferta korrente dhe transferta kapitale.

mjetesh te tjera te rezervave valutore shteterore, eshte pare e arsyeshme qe bilanci i pagesave te pasqyroje vecazi ata komponente qe konsiderohen si perberes te rezervave ne mjete valutore te autoriteteve monetare dhe qe perdoren per te perballuar nevojat e bilancit te pagesave.

2.10 Sipas Manualit te Bilancit te Pagesave, rezervat konsistojne ne ato mjete te huaja financiare, qe kontrollohen dhe jane te gatshme per t'u perdorur nga autoritetet monetare te nje vendi, per financimin e cbalancimeve te pagesave nderkombetare, per nderhyrje ne tregjet valutore etj.

Klasifikimi i Bilancit Shqiptar te Pagesave

2.11 Ne Tabelen 1 paraqitet nje pasqyre e zerave standarte te bilancit te pagesave. Kjo liste zerash paraqitet ketu per te krijuar nje baze diskutimi mbi aspekte te tjera te ketyre statistikave, ndersa diskutimi ne detaje i ketyre zerave do te behet ne kapitujt pasardhes.

TABELA Nr.1

A. Llogaria korrente

Mallra, Sherbime dhe te Ardhura

1. Mallrat ne f.o.b.

1a. Mallra nga ndihmat

1b. Mallra nga migrantet

1c. Automjete te perdorura

1d. Te tjera

2. Sherbime

- 2a. Sherbime transporti
 - i. Navllo
 - ii. Transport pasagjeresh
 - iii. Te tjera
- 2b. Sherbime sigurimi
- 2c. Udhetim
- 2d. Sherbime te tjera
 - i. Sherbime komunikacioni
 - ii. Asistence teknike
 - iii. Sherbime qeveritare
 - iv. Te tjera

- 3. Te ardhura
 - 3a. Te ardhura nga puna
 - 3b. Te ardhura nga investimet
 - i. Interesa mbi rezervat
 - ii. Te ardhura te tjera interesash
 - iii. Te ardhura kapitali

- 4. Transferta korrente
 - 4a. Ndhima shtetore nga jashte
 - i. Asistence teknike
 - ii. Ndhima ne kesh
 - iii. Mallra dhe ndihma te tjera
 - 4b. Dergesa nga te catdhesuarit
 - 4c. Te tjera

Bilanci i Llogarise Korrente

- perjashtuar transfertat shtetore

B. Llogaria Kapitale

- I. Transfertat Kapitale
- II. Llogaria Financiare

- 1. Detyrimet
 - 1a. Investime kapitale
 - 1b. Huamartje shtetore
 - 1c. Kredi dhe hua nga FMN
 - 1d. Ripagime (shlyerje)
 - 1e. Monedhe e depozita
 - 1f. Kredi tregtare
 - 1g. Ndryshimi i detyrimeve

- 2. Mjetet
 - 2a. Investime kapitale
 - 2b. Depozita
 - 2c. Monedhe
 - 2d. Mjete te tjera

C. Rezervat

- 1. Ar
- 2. Mjete valutore
- 3. SDR

4. Pozicioni i rezerves ne Fond

D. Gabime dhe harresa

Rregjistrimi bruto/neto

2.12 Ne llogarine korrente *eksportet fob* dhe *importet fob* rregjistrohen perkatesisht ne kredi dhe debi te kategorise **Mallra**. Me perjashtime te rralla, gjithë zerat e tjere te llogarise korrente trajtohen ne te njejten menyre, d.m.th. rregjistrohen *bruto* (kreditohehen dhe debitohehen vecazi). Si perjashtime permenden raste te tilla si ai i netimit te te ardhurave kapitale per nje shume te barabarte me diferencen e te ardhurave te arketueshme nga jashte dhe te ardhurave te pagueshme jashte.

2.13 Ndryshe nga llogaria korrente ku, per shumicen e zerave, aplikohet rregjistrimi bruto, llogaria kapitale ndertohet mbi bazen e nje rregjistrimi *neto*. Rregjistrimi neto, qofte ne debi apo kredi, pasqyron efektin neto te te gjitha rritjeve apo reduktimeve te zoterimeve ne mjete, qe klasifikohen nen nje ze te caktuar, gjate periudhes perkatese. P.sh. blerja (nga jo rezidentet) e letrave me vlere te emetuara nga njesi rezidente netohen me shitjen (nga jo rezidentet) e ketyre letrave me vlere dhe ne bilancin e pagesave rregjistrohet vetem ndryshimi neto per kete ze. Nje nga arsyet perse rregjistrimi neto preferohet ne llogarine kapitale eshte mungesa e te dhenave bruto. Pervec kesaj, rregjistrimi neto, shpesh paraqet me shume interes se ai bruto per faktin se ne te spikat me mire rezultati i transaksioneve ndermjet rezidenteve dhe jorezidenteve. Megjithate, kjo nuk e perjashton perfundimisht rregjistrimin bruto, i cili mund te jete mjaft i dobishem per qellime analitike. Investimet direkte, per qellime analitike, figurojne ne shifra te vecanta per *detyrimet* neto te ndermarrjeve te afiliuara rezidente ndaj investitoreve te huaj direkte dhe per pretendimet neto (*mjetet*) te investitoreve rezidente direkte mbi ndermarjet e huaja te afiliuara.

MALLRAT

Hyrje

3.1 Ne vazhdim do te trajtohen zerat e bilancit te pagesave dhe do te pershkruhen aspektet e lidhura me kuptimin e cdo zeri dhe vleresimi i tij ne kete bilanc. Ne pergjithesi, zerat e pershkruar jane ato te paraqitura ne tabelen Nr.1 te kapitullit II, megjithate, ku eshte e pershtatshme dhe per te mos rene ne perseritje, dy ose me shume zera qe jane shume te ngjashem ndermjet tyre mund te trajtohen njekohesisht.

3.2 Pershkrimi i cdo zeri perfshin pikat e meposhtme:

- konceptet dhe percaktimet
- klasifikimin
- koha e rregjistrimit
- vleresimin
- burimi i te dhenave

3.3 Ndoth shpesh qe te dhenat mujore (ose tremujore) per zera te ndryshem te bilancit te behen te vlefshme (vihen ne dispozicion) pas botimit te bilancit; ne keto rrethana eshte normale te vleresohet periudha ne fjale nepermjet ekstrapolimit te te dhenave te periudhave te meparshme.

3.4 Eshte e rendesishme qe gjate leximit te ketij kapitulli dhe te atyre me pas te mbahet mend se zerat e bilancit te pagesave jane subjekt i revizionimeve te vazhdueshme, qe vijne si pasoje e revizionomit te te dhenave, ardhjes se te dhenave shtese, permiresimit te metodologjise se vleresimit etj.

Trajtimi dhe Principet

3.5 Sic percaktohet ne Manualin e peste te Fondi Monetar Nderkombetar kategoria mallra mbulon: *mallrat e pergjithshme, mallrat per perpunim, riparimet e mallrave, mallrat e blera ne porte dhe arin jomonetar*. Ne pershtatje me parimet e pergjithshme te bilancit te pagesave, ndryshimi i pronesise percakton ekzistencen dhe kohen e rregjistrimit te transaksioneve nderkombetare ne mallra. Eksportet dhe importet e mallrave rregjistrohen nga doganat dhe vleresohen me cmimin e tregut.

Klasifikimi dhe Perkufizimet

3.6 *Mallra te pergjithshme* i referohen me disa perjashtime qe do te trajtohen ne paragrafet pasardhes, mallrave te levizshem, pronesia e te cileve kalon nga rezidentet te jorezidentet dhe anasjelltas.

3.7 *Mallra per perpunim* mbulon mallrat qe jane eksportuar ose importuar per perpunim dhe qe sjellin si rrjedhim dy transaksione: i. eksporti i nje malli (psh. nafte bruto, pjese makinash, pambuku etj) dhe ii. riimporti i mallit te perpunuar (benzina, veshjet etj) mbi bazen e nje kontrate dhe kundrejt nje shperblimi. Rregjistrimi bruto (rregjistrimi i mallrave nga dogana me vleren e tyre te plote para dhe pas perpunimit) i ketyre transaksioneve ne kategorine mallra perben nje perjashtim nga rregulli i ndryshimit te pronesise.

3.8 Perjashtohen nga kategoria *mallra per perpunim* ato mallra qe pas perpunimit nuk kthehen ne vendin e origjines. Keto mallra perfshihen nen zerin **mallra te pergjithshme**. Pagesa per perpunimin shkakton nje rregjistrim ne debi te **sherbimeve** dhe gjithashtu nje axhustim ne shifren e eksporteve per te perfshire vleren e perpunimit.

3.9 Kategoria *riparimet e mallrave* mbulon aktivitetin e riparimeve qe perfshin punen e kryer nga rezidentet mbi mallrat e levizshme qe jane prone e jorezidenteve (ose e anasjellta). Ne

ndryshim nga perpunimi, vlera e rregjistruar ketu, perfaqson vleren e riparimit dhe jo vleren bruto te mallit para dhe pas riparimit. Manuali rekomandon qe vlera e **te gjithë riparimeve** te perfshihet ne **mallrat**. Perjashtohen nga kjo kategori: riparimet e konstruksioneve (rregjistrohen ne sherbime konstruksionesh), riparimet e kompjuterave (rregjistrohen ne sherbime kompjuterash dhe informacioni), mirembajtja ne porte dhe aeroporte e mjeteve te transportit (rregjistrohet ne sherbime transporti).

3.10 *Mallrat e blera ne porte.* Kjo kategori perfshin mallrat (psh. karburantet, ushqimet, rezervat e ndryshme etj) te siguruara nga rezidentet jashte dhe mallrat qe jorezidentet marrin ne ekonomine tone. Perjashtohen nga ky ze sherbimet qe lidhen me keto mallra, keto sherbime rregjistrohen ne zerin sherbime te tjera transporti.

3.11 *Ari jomonetar* mbulon eksportet dhe importet e te gjithë arit qe nuk mbahet si mjet rezerve (ari monetar) nga autoritetet monetare. Ari jomonetar, trajtohet si cdo lloj tjetër malli dhe kur eshte e mundur, ai ndahet ne ar industrial dhe ne ar stoli.

3.12 Klasifikimi i paraqitur me lart, ka si synim te sherbeje si nje udhezues ne hartimin e statistikave te bilancit te pagesave dhe si i tille, ai nuk eshte nje klasifikim standart i detyrueshem. Cdo vend, mund te ndertoje nje klasifikim te vetin ne perputhje me karakteristikat specifike te tregtise se tij te jashtme, nga ana tjetër nje vend mund te perdore me shume se nje klasifikim. Ne pergjithesi hartimi i nje klasifikimi (ashtu edhe ai i tregtise se jashtme) behet mbi bazen e nje kriteri te vetem (p.sh. klasifikim sipas menyres se financimit, sipas grupmallrave etj), por nuk perjashtohet mundesia e nje klasifikimi te ndertuar sipas disa kriterëve, ku shuma e zerave te tij nuk eshte e thene te jape doemos **totalin** e eksporteve apo te importeve.

Ne mungese te nje sistemi efektiv te statistikave te tregtise se jashtme e atyre doganore, klasifikimi i permendur me lart behet i pavlefshem (nuk eshte plotesisht i realizueshem) dhe ben te nevojshem perdorimin e klasifikimeve te tjera. Ne vazhdim jane paraqitur dy klasifikime te tregtise se jashtme te perdorur ne bilancin tone te pagesave. Varianti i pare eshte nje klasifikim sipas grupmallrave, i dyti eshte nje klasifikim sipas dy kriterëve : i. grup mallrave, ii. menyres se financimit.

i. Mallrat ne f.o.b.

- **Mallrat e pergjithshme**
- **Mallra per perpunim**
- **Mallra ndihma**

ii. Mallrat ne f.o.b.

- **Mallrat e pergjithshme**
- **Mallra nga ndihmat**
- **Mallra nga migrantet**
- **Automjete te perdorura**

Marreveshja per rregjistrimin

3.13 Mallrat e eksportuara si regull e ndryshojne pronesine ne momentin qe eksportuesi i fshin ato nga librat e tij si mjete reale (p.sh. kur ai rregjistron nje shitje) dhe ben rregjistrimin korrespondues ne zerat financiare. Mallrat e importuara e ndryshojne pronesine kur importuesi i rregjistron ato ne librat e tij si mjete reale (p.sh. kur ai rregjistron nje blerje). Kjo marreveshje eshte bere qe te siguroje konsistence ndermjet zerit mallra dhe llogarise financiare ne bilancin e pagesave te vendit perpilues, ashtu sikurse per te pasur konsistence ndermjet zerit mallra te rregjistruar nga vendet eksportuese dhe importuese.

Perjashtime nga rregulli i ndryshimit te pronesise

3.14 Perkufizimi i rezidences i paraqitur ne kete manual e nderlikon konceptin e ndryshimit te pronesise. Konkretisht, megjithese ndermarrjet konsiderohen gjithmone rezidente te ekonomive ne te cilat ato operojne, nga pikpamja e pronesise ato mund te trajtohen si nje njesi e vetme. Ndermarrjet e ndervarura (psh. rasti i nje dege me ndermarrjen meme) mundet te perfshihen ne transaksione qe nuk jane subjekt i ndryshimit legal te pronesise, qe ndeshet ne rastin kur ndermarrjet jane te pavarura nga njera-tjetra. Si rrjedhim, ne te tilla raste ku nuk ndeshet ndryshimi real i pronesise, Manuali rekomandon qe transaksionet te cilat perfshijne mallrat dhe ndodhin ndermjet nje ndermarrje investimi direkt dhe nje kompanie meme, ose ndermjet ndermarrjeve te lidhura (ndervarura) duhet te trajtohen sikur ndryshimi i pronesise te kete ndodhur.

3.15 Ka gjithashtu raste te tjera te rendesishme, ne te cilat posedimi i nje malli kalon nga rezidentet te jorezidentet qe nuk jane te ndervarur, pa u ndeshur ne fakt ndryshimi i pronesise. Per shume arsye, ne keto transaksione, ndryshimi i pronesise mund te konsiderohet si i mireqene. Nje rast mjaft domethenes eshte lizingu financiar. Manuali rekomandon qe natyra ekonomike e ketyre transaksioneve duhet te kete percedence ndaj formes se tyre legale. Ne keto raste supozojme se ndodh ndryshimi i pronesise dhe si rrjedhim nen zerin **mallra** do te rregjistrohet vlera e plote e tregut per paisjen e marre me kontraten e lizingut dhe nga ana tjetere do te behet nje rregjistrim balancues ne **llogarine financiare** (ne kredit).

Perfshirja ne eksporte ose importe te mallrave qe nuk kryqezojne kufijte.

3.16 Mallrat qe nuk i kryqezojne kufijte, por per te cilat ndodh ndryshimi i pronesise duhet te perfshihen ne eksporte dhe importe. Perjashtim bejne ndryshimet e perkohshme te pronesise, ose ato ndryshime te pronesise qe nuk kane natyren e mirfillte te aktivitetit ekonomik. Shembuj te mallrave qe nuk kryqezojne kufijte, por qe duhet te perfshihen ne eksporte e importe jane:

- anijet, avionet, mjetet e transportit hekurudhor, platformat e nafte e te tjera paisje te levizshme qe nuk qendrojne ne nje rajon te caktuar.
- ari jomonetar.
- mjetet e transportit, platformat e nafte qe operojne ne ujrat ose hapesirat nderkombetare te cilat u shiten jorezidenteve.

- mallrat e peshkuar ose te shpetuar dhe produkte te tjera detare te kapura nga anijet e ekonomise qe harton bilancin, te cilat u shiten direkt jorezidenteve.
- mallra te blera jashte shtetit nga qeveria per qellime te perdorimit te saj jashte shtetit.

Perjashtime nga eksportet dhe importet te mallrave qe kryqezojne kufijte, por qe nuk ndryshojne pronesine.

3.17 Mallrat qe kryqezojne kufijte por qe nuk e ndryshojne pronesine nuk do te trajtohen nen kategorine **mallra**, me perjashtim te rasteve te permendura ne paragrafet e meparshem.

Mallrat qe klasifikohen nen zerat e tjere

3.18 Ndersa pjesa me e madhe e mallrave te levizshem, pronesia e te cilave ndryshon ndermjet rezidenteve dhe jorezidenteve klasifikohen nen kategorine **mallra**, nje numer i vogel mallrash klasifikohen nen zera te tjere.

Mallrat e klasifikuara nen zerin sherbime

3.19 Disa mallra jane klasifikuar nen zerin **sherbime** sepse informacioni i mbledhur i perfshin keto mallra ne menyre te padallueshme nga sherbimet me te cilat ato jane te lidhura, ose sepse mallrat kane natyre te ndryshme nga mallrat ne pergjithesi. Shembuj te mallrave te perfshira ne kategorine **sherbime** (dhe zerat nen te cilat keto mallra perfshihen) jane:

mallrat e blera nga turistet per perdorim vetjak (*udhetime*), nga diplomatet dhe misionaret ushtarake ose nga personeli shteteror (*sherbime qeveritare*), dhe nga punetoret jorezidente (*udhetime*), gazetate dhe periodiket (jo ne sasi) te derguara per abonentet (*sherbime kompiuterash dhe informacioni*) etj.

Mallrat e trajtuar si zera financiar

3.20 Ka disa mallra te cilet konsiderohen si zera financiare dhe si rrjedhim nuk duhet te perfshihen nen kategorine **mallra**.

Shembuj te tyre jane:

Misheruesit e detyrimeve financiare. Si te tille mund te permendim kartmonedhat dhe monedhat ne qarkullim dhe letrat me vlere te emetuara.

Ari monetar trajtohet si ze financiar, keshtu transakcionet ndermjet autoriteteve monetare te ekonomive te ndryshme duhet te perfshihen ne **llogarine financiare** dhe jo ne **mallra**.

Mjetet jofinanciare (perfshire token, konstruksionet, paisjet, dhe patentat) qe i perkasin nje ndermarrjeje, konsiderohen mjete financiare per zoteruesin e kesaj ndermarrjeje, kur zoteruesi

nuk është rezident i ekonomisë në të cilën operon ndërmarrja. Ndryshimi i pronësive të këtyre mjeteve trajtohet si një transaksion financiar dhe nuk do të përfshihet në **mallrat**.

Raste të veçanta të mallrave

3.21 Klasifikimi i sendeve fizike si mallra është ndonjëherë me pikepyetje, kjo për arsye të këtyre mallrave mund të kene trajtim të veçantë në rregulloret doganore, ose në raportet tregtare. Shembuj të këtyre mallrave, të cilët duhet të përfshihen të gjithë nën kategorinë mallra n.q.s. u përmbahen përcaktimeve dhe rregullave të *Manualit* janë:

- ari jomonetar, argjendi, diamanti dhe metalet e guret e tjere të cmuar.
- kartmonedhat dhe monedhat jashtë qarkullimit dhe letrat me vlerë të pa emetuara, të gjitha këto duhet të vlerësohen si mallra dhe jo me vlerën e tyre si mjete financiare.
- elektriciteti, gaz dhe uji
- bagetia që kalon nga kufijtë
- pakot postare
- eksportet dhe importet qeveritare të financuara nga ndihmat dhe huatë
- mallrat nga migrantët
- mallrat kontrabande që kalojnë ose jo nga doganat
- ngarkesa të tjera të pa rregjistruara siç janë dhuratat etj.

Koha e Rregjistrimit

3.22 Në parim eksportet dhe importet e mallrave duhet të rregjistrohen kur pronësia e mallrave kalon nga rezidentët të jorezidentët dhe anasjelltas. Në praktikë, si moment i ndryshimit të pronësive pranohet momenti kur të dy palët pjesëmarrëse në transaksion e rregjistrojnë ato në librat ose në llogaritë e tyre.

3.23 As levizja fizike e mallrave mbi të cilën bazohen raportet zyrtare tregtare, as pagesa, e cila reflektohet në ndryshimin e mjeteve valutore nuk koïncidojnë patjetër në kohë me ndryshimin e pronësive të mallrave. Nga ana tjetër, është shumë e vështirë në kushtet aktuale të përcaktohet momenti në të cilin palët e rregjistrojnë transaksionet në librat ose në llogaritë e tyre, prandaj në bilancin tone të pagesave si moment i ndryshimit të pronësive pranohet momenti në të cilin mallrat kalojnë kufirin doganor.

3.24 Mallrat në dorezim (destinuar për shitje por që nuk janë shitur në momentin që ato kalojnë doganat) duhet të paraqiten në bilancin e pagesave vetëm në momentin e ndryshimit të pronësive. Në praktikë këto mallra rregjistrohen në momentin kur ato kalojnë kufijtë doganor. Në të tilla raste supozohet se ndryshimi i pronësive ka ndodhur, ose do të ndodhë së shpejti. N.q.s. këto mallra trajtohen si me siper, por ndryshimi i pronësive nuk ndodh në fakt, atëherë do të behet

nje rregjistrim tjetër si në rastin e eksporteve dhe importeve të rikthyera, pra një zbritje nga eksportet dhe importet.

Vleresimi

3.25 Vlera me të cilën mallrat duhet të rregjistrohen në bilancin e pagesave, është çmimi i tregut në pikën uniforme (homogjene) të vleresimit që është kufiri doganor i ekonomisë eksportuese të mallrave. Kjo është arsyeja që mallrat rregjistrohen f.o.b. në keta kufij.

Pika e vleresimit

3.26 Manuali i peste i bilancit të pagesave përqipet që të bëjë një dallim të qartë ndërmjet: i. artikujve që do të trajtohen si mallra dhe ii. shërbimeve shtesë të shpërndarjes (transportit, ngarkim shkarkimit) që mund të përfshihen në vlerën përfundimtare të këtyre mallrave. (Ky dallim është bërë pa i'u referuar faktit nëse shërbimet e shpërndarjes janë bërë para ose pasi ka ndodhur ndryshimi i pronësive.) Kështu, mallrat duhet të vlerësohen në mënyrë uniforme mbi bazën e një rregulli standart, i cili cakton një kufi ndares të qartë ndërmjet mallrave dhe shërbimeve të shpërndarjes.

3.27 Ky rregull thotë se nën kategorinë *mallra* do të përfshihet vlera e mallrave dhe shërbimet e shpërndarjes të lidhura me to, deri në momentin që malli mbërrin në kufijtë doganor të vendit eksportues. Vlera e mallrave përfshin edhe vlerën e shërbimeve të ngarkimit dhe të transportit deri në kufijtë doganor të ekonomisë eksportuese. Kjo është arsyeja pse eksportet dhe importet vlerësohen f.o.b. në kufijtë doganor të ekonomisë eksportuese. Nuk është e thënë që kufijtë doganor të përputhen fizikisht me kufijtë kombëtar, ato mund të vendosen brenda territorit ekonomik të një vendi.

3.28 Një uniformitet i tillë, nënkupton që praktikën e ndryshme të livrimit të mallrave nga vendet eksportuese, si dhe ndryshimet në këtë praktikë nga një periudhë në tjetrën, nuk do të kenë ndonjë efekt në përkufizimin (përcaktimin) e shërbimeve të përfshira në vlerën e mallrave. Qëllimi është që në kategorinë mallra të përfshihen vetëm një pjesë e shërbimeve të shpërndarjes që janë të lidhura me to.

3.29 Konsiderata kryesore në përcaktimin e kufirit doganor të ekonomisë eksportuese, është pika në të cilën zyrtarët doganorë vendosin vlerësimin e tyre për eksportet dhe për një grup të madh vendesh edhe për importet.

Burimi i të dhënave

3.30 Të dhënat e nevojshme për kompilimin e kategorisë **Mallra** të bilancit të pagesave, sigurohen nga sektori i statistikës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Këtu bëhet përpunimi i informatizuar një për një i të gjitha deklaratave doganore nga të gjitha pikat doganore. Informacioni i përpunuar paraqitet në mënyrë të përmbledhur pranë sektorit të bilancit të pagesave nëpërmjet tabelave Nr.2 e Nr.3¹ përkatesisht për eksportin dhe importin. Mbeshtetur në këto të dhëna sektori i bilancit të pagesave nxjerr vlerësimin e tij për eksportin dhe importin

¹ Tabelat dhe Formularet e përmendura në vazhdim do t'i gjëni në Shtojcën e kësaj metodike

pasi ben axhustimet e nevojshme qe jane: i. kthimi i vleres cif te importeve ne fob, ii. rillogaritja e vleres se automjeteve te perdorura, iii. nje vleresim per mallrat qe kalojne kufirin kontrabande pa u rregjistruar nga zyrat doganore, si dhe axhustime te tjera per raste te vecanta.

SHERBIMET

HYRJE

4.1 Kategoria sherbime ne bilancin e pagesave mbulon te gjitha sherbimet qe rezidentet e nje ekonomie u kryejne jorezidenteve (kredi) dhe ato te kryera nga jo rezidentet, rezidenteve (debi) si edhe disa transaksione ne mallra qe, per arsye praktike, perfshihen ne sherbimet me te cilat ato lidhen. Sherbimet qe do te pershkruhen me tej jane:

- sherbime transporti
- sherbime sigurimi
- sherbime udhetimi
- sherbime te tjera

TRANSPORTI

Koncepte dhe perkufizime

4.2 Kjo kategori perfshin gjithë shërbimet e transportit (detar, ajror e tokesor) qe rezidentet e nje ekonomie u bejne jorezidenteve dhe anasjelltas, duke perfshire levizjen e mallrave, transportin e pasagjereve, shumat e paguara si qira mbi mjetet e transportit (charter) dhe shërbime ndihmese te lidhura me to. Perjashtohen nga kjo kategori disa aktivitete te lidhura me keto shërbime si sigurimi i mallrave, i cili perfshihet ne zerin "*Sigurime*", mallrat e siguruara ne porte nga jorezidentet dhe riparimet e mjeteve te transportit qe perfshihen ne kategorine **mallra**.

4.3 **Navllo** mbulon shërbimet e transportit te mallrave. Ne kete ze futen gjithashtu shërbimet e ngarkimit apo shkarkimit te mallrave nga transportuesit, nese kontratat midis importuesit/eksportuesit te mallrave dhe transportuesit kerkojne qe ky i fundit te siguroje keto shërbime. Kur shërbimet e ngarkimit kryhen ne doganen kufitare te vendit eksportues, pagesa per ngarkimin do te klasifikohet si Navllo nese shërbimi eshte siguruar nga ose per llogari te transportuesit, ne te kundert shërbimi klasifikohet si pjese e zerit mallra.

4.4 Llogaritja e shërbimeve te transportit ndikohet nga marreveshja, sipas se ciles mallrat vleresohen f.o.b. ne kufirin doganor te ekonomise eksportuese dhe nga supozimi qe pagesat per transportin perballohen nga ekonomia importuese. Ne vleren f.o.b. te mallrave perfshihen gjithashtu shërbimet e transportit qe kryhen para mberrijtes se mallrave ne kufirin doganor te ekonomise eksportuese. Ne shërbimet e transportit perfshihen ato shërbime qe kryhen pertej kufirit te ekonomise eksportuese deri ne kufirin e ekonomise importuese dhe brenda saj deri ne piken e shperndarjes. Nje rregjistrim ne debi te llogarise se ekonomise importuese do te behej per shërbime brenda ose jashte saj ne lidhje me importet kur keto shërbime kryhen nga jorezidentet, per transportimin pertej kufirit te ekonomise eksportuese. Anasjelltas, rregjistrimet ne kredi te llogarise se ekonomise eksportuese, i takojne shërbimeve te transportit lidhur me eksportet e saj kur keto shërbime kryhen pasi mallrat jane ngarkuar ne bord ne kufirin e saj doganor.

4.5 Ne zerin *Navllo* rregjistrohen edhe shërbimet e kryera nga rezidentet ne lidhje me transportin e mallrave ndermjet vendeve te treta (ne kredi te ketij zeri paraqiten te ardhurat nga flota shtetore per shërbimet e transportit qe ajo u kryen jorezidenteve ne transportin nderkombetar ndermjet porteve te huaja detare), si dhe shërbimet e transportit per mallrat tranzit ne ekonomine hartuese. Keto rregjistrime perfaqesojne shërbime te kryera nga rezidentet apo jorezidentet pa marre parasysh faktin nese pronesia e mallrave ne kohen e kryerjes se ketyre shërbimeve u perket rezidenteve apo jorezidenteve. Ne rastet kur mallrat vleresohen c.i.f. ne kufirin doganor te ekonomise importuese, eshte e nevojshme qe vlere e shërbimeve te transportit te paraqitet e ndare nga vlere e mallrave.

Sherbime pasagjeresh

4.6 Ky komponent mbulon te gjitha shërbimet e kryera ndermjet ekonomise hartuese dhe "botes" (jorezidenteve), ose ndermjet dy ekonomive te huaja ne transportin nderkombetar te pasagjereve jorezident nga transportuesit rezidente (kredi) dhe ate te rezidenteve nga transportuesit jorezident (debi). Perfshihen ketu edhe shërbimet e kryera brenda nje ekonomie nga transportues jorezident. Perjashtohen nga kjo kategori shërbimet qe transportuesit rezidente u bejne jorezidenteve brenda ekonomive te tyre, keto shërbime perfshihen ne zerin "*Udhetime*".

Pervec sherbimeve te permendura me lart, ketu perfshihen edhe pagesa per bagazhe, automjete apo shpenzime te tjera personale per ushqim, pije etj.

Transporte te tjera

4.7 Kjo kategori perfshin sherbimet qe kryhen ne porte, aeroporte dhe lehtesira te tjera portuale. Si te tilla mund te permendim: ngarkim-shkarkimi i konteniereve, depozitimi, magazinimi, ambalazhimi i mallrave; sherbime ndihme si rimorkime, pilotime, operacione shpetimi etj. Perfshihen nen kete kategori edhe pagesa e komisione mbi transportin e mallrave e te pasagjereve.

Si burim plotesues informacioni per vleresimin e nenzerave, sherbime pasagjeresh dhe sherbime te tjera transporti, te zerit "Transporte", sherben Formulari Nr. 1. i Bilancit te Pagesave i cili permban te dhena mbi flukset e pagesave dhe arketimeve nga transporti i pasagjereve, sherbimet portuale, sherbime sigurimi, si dhe sherbime te tjera.

4.8 Burimi kryesor i te dhenave per vleresimin e ketyre zerave eshte Instituti i Statistikes. Informacioni merret ne menyre te permbledhur nepermjet Formulareve tremujore Nr. 4, Nr. 5, Nr. 6 dhe Nr. 7. Si informacion suplementar mund te sherbeje Formulari nr.1 qe plotesohet nga sistemi bankar me frekuence mujore.

SHERBIME SIGURIMI

Natyra e sigurimeve

4.9 Sherbimet e sigurimit mbulojne lloje te ndryshme sigurimi qe ndermarrjet e sigurimit rezidente u kryejne jorezidenteve dhe anasjelltas. Sherbime te tilla mbulojne *sigurimin e mallrave* (p.sh sigurimi i mallrave ne procesin e eksport-importit); tipe te tjera te *sigurimit direkt* (p.sh sigurim jete, perfshi ketu edhe pensione e sherbime vjetore, aksidente te ndryshme, etj.) dhe *risigurimin*. Ne sherbimet e sigurimit perfshihen gjithashtu komisionet e agjenteve lidhur me sherbimet e sigurimit. Vende te ndryshme mund te aplikojne klasifikime te hollesishme te tipeve te ndryshme te sigurimeve duke marre parasysh vecorite e tyre specifike. Ne bilancin tone te pagesave sherbimet e sigurimit paraqiten neto nen zerin sherbime sigurimi.

Vleresimi i sherbimeve te sigurimit

4.10 Trajtimi i sigurimit te mallrave eshte konsistent me vleresimin f.o.b. te importeve dhe eksporteve: i. kostoja e sigurimit deri ne kufirin doganor te ekonomise eksportuese perfshihet ne vleren f.o.b. te mallrave te eksportuara. Sherbimi i sigurimit te mallrave pasi ato te kene kapercyer kufirin doganor te ekonomise eksportuese, rregjistrohet si import sherbimesh nga importuesi, ne rastet kur ky sigurohet nga nje ndermarrje jorezidente per ekonomine importuese. (Nuk behet asnje rregjistrim ne bilancin e pagesave ne rastet kur sherbimi sigurohet nga nje ndermarrje rezidente e ekonomise importuese).

4.11 Pra per mallrat, pagesat per sherbimin e sigurimit qe rezidentet u sigurojne jorezidenteve (kredi), perbejne diferencen midis **premiove te fituara** dhe **pretendimeve te paguara** mbi

mallrat e humbura apo te shkaterruara gjate transportimit. Sherbimet e sigurimit qe jorezidentet u bejne rezidenteve (debit) mund te vleresohen nga raporti i pagesave te vleresuara per sherbimet ndaj premiove totale per eksportet e ketyre sherbimeve dhe duke aplikuar kete raport ndaj premiove totale paguar jorezidenteve. Ky raport duhet te bazohet nga periudha afatmesme ne ato afatgjata. Per sherbimet jojetesore te sigurimit, totali i premiove minus vleren e parashikuar te sherbimit dhe pretendimet e pagueshme do te duhej te rregjistrohej ne **transfertat korrente**. Persa i perket sigurimit te jetes, premiot minus vleren e sherbimit dhe te pretendimeve te pagueshme do te duhej te rregjistrohej ne zerin *investime te tjera*, ne **llogarine financiare**.

4.11 Per vleresimin e sherbimeve te sigurimit shfrytezohet informacioni i siguruar nga Formulari Nr. 10 qe plotesohet nga Instituti i Sigurimrve (INSIG) me frekuence tremujore.

UDHETIME

Natyra e Sherbimeve te Udhetimes

4.12 Sherbimet e Udhetimes ndryshojne nga komponentet e tjere te sherbimeve nderkombetare per faktin se ato kane te beje me nje aktivitet te kerkuar dhe te orientuar. Konsumatori (udhetari) leviz ne vendin mikprites (e huaj) duke siguruar mallrat dhe sherbimet e deshiruara nga ai. Keshtu, ndryshe nga sherbimet e tjera, udhetimi nuk eshte nje tip sherbimi por nje asortimet sherbimesh i konsumuar nga udhetaret.

Perkufizim

4.13 Zeri **Udhetime** mbulon kryesisht mallrat dhe sherbimet e *perfituara* nga turistet (udhetaret) gjate vizitave te tyre per nje periudhe me te shkurter se nje vit, ne ekonomine mikpritese. Ketu perfshihen mallrat dhe sherbimet qe blihen nga ose ne emer te vizitorit, si dhe ato qe ai i perfiton si dhurata. Perjashtohet nga kjo kategori transporti nderkombetar i udhetareve, i cili mbulohet nga zeri *Sherbime pasagjeresh*.

4.14 Udhetar quhet ai individ i cili qendron per me pak se nje vit, ne nje ekonomi ne te cilen ai nuk eshte rezident per cdo arsye tjeter pervec rasteve kur i. eshte vendosur ne nje baze ushtarake, ambassade apo ne nje agjensi te qeverise se tij; ii. eshte perfshire ne nje aktivitet prodhues ne nje ndermarrje rezidente te ekonomise ne fjale. Udhetaret perfshijne gjithashtu edhe turistet qe qendrojne te pakten nje nate, ose me pak se 24 ore.

Shpenzimet e bera nga individet e perfshire ne piken i. rregjistrohen nen zerin *Shpenzime qeveritare*, ndersa ato te bera nga individet qe trajtohen ne ii. (perfshire dhe punetoret sezonale) rregjistrohen ne zerin *Udhetime*.

4.15 Rregulli i qendrimit me pak se nje vit nuk aplikohet mbi studentet dhe pacientet, te cilet mbeten rezidente te vendit te tyre te origjines. Te gjitha shpenzimet e bera per edukimin, shendetin dhe jetesen e tyre rregjistrohen ne zerin "Udhetime".

Llojet e Udhetimes

4.16 Zeri *Udhetime* mbulon dy kategori udhetimesh: udhetime biznesi dhe udhetime personale.

Udhetime biznesi

4.17 Kategoria e udhetimeve te biznesit perfshin udhetaret te cilet udhetojne jashte per te gjitha llojet e aktivitetit te biznesit: ekuipazhet e transportit, nepunesit qeveritare dhe punonjes te organizatave nderkombetare ne udhetime zyrtare si dhe punetoret sezonale e ata kufitare. Udhetare te biznesit konsiderohen ata qe vizitojne nje ekonomi per pjesemarrje ne negociata tregtare, panaire, misione, mbledhje, etj ne emer te nje ndermarrjeje apo institucioni jorezident ne kete ekonomi. Ne zerin *Udhetime* rregjistrohen blerjet e mallrave dhe sherbimeve personale (perfshire ato per te cilat udhetaret e biznesit shperblehen si punonjes) dhe jo blerjet ne emer te organizatave te cilat ata perfaqesojne. Rregjistrohen ne zerin *Udhetime*, shpenzimet personale te bera nga punonjesit sezonale dhe ata kufitare ne ekonomine ne te cilen jane punesuar.

Udhetime Personale

4.18 Ne kete kategori perfshihen vizitoret qe udhetojne jashte per qellime pushimi, studimi, aresye shendetesore, pjesemarrje ne aktivitete sportive, kulturore, pelegrinazhi, vizitoret tranzit, etj.

Burimi i informacionit, vleresimi dhe rregjistrimi

4.19 Ne praktiken tone sherbimet e udhetimit paraqiten neto ne zerin *Udhetime*. Per llogaritjen e shpenzimeve te udhetareve qe vizitojne Shqiperine (kredi), merret parasysh numri i udhetareve qe hyjne ne Shqiperi, koheqendrimi i tyre mesatar si dhe nje vleresim mbi shpenzimet ditore te cdo udhetari. Informacioni i nevojshem sigurohet nga Formularet per Bilancin e Pagesave Nr. 13 e 15. Formulari Nr. 13 plotesohet cdo tremujor nga Ministria e Turizmit, ky formular siguron informacion te plote mbi numrin, koheqendrimin dhe te ardhurat e arketuara nga turistet e akomoduar ne strukturat hoteliere shteterore. Informacioni mbi numrin total te hyrjeve e daljeve te jorezidenteve ne dhe nga Shqiperia sigurohet nga Formulari Nr. 15 i cili plotesohet regullisht cdo muaj nga Ministria e Brendeshme.

Ne debi te ketij zeri, perfshihen shpenzimet e udhetimit te nepunesve qeveritare, shpenzimet per studime e bursa ato te pacienteve per kurim si dhe shpenzimet e bera ne udhetaret private per qellime turizmi ose biznesi. Llogaritja e ketyre shpenzimeve bazohet ne Formularin Nr. 9 plotesimi i te cilit mbi baze tremujore i eshte besuar Ministrise se Financave. Gjithashtu si burim suplementar informacioni perdoren: i. Formulari Nr.1 dhe ii. te dhenat e siguruara nga institucione te tjera (per udhetime e sherbimit) qe nuk perfshihen ne Formularin e Ministrise se Financave. Shpenzimet e bera ne udhetime private llogariten si nje perqindje e vleresuar mbi shpenzimet e udhetimit te sektorit shteteror. Vleresimet mbi shpenzimet e udhetimit bazohen ne informacionin e siguruar nga Karta e Hyrjes e cila plotesohet ne pikat doganore nga te gjitha udhetaret rezidente e jorezidente qe hyjne ose dalin nga Shqiperia.

SHERBIME TE TJERA

4.20 Ne Sherbime te tjera perfshihen ato transaksione te sherbimeve nderkombetare te pa perfshira ne grupimet e mesiperme si: *Transporte, Sigurime dhe Udhetime*. Ne te perfshihen keto zera:

- Sherbime komunikacioni
- Asistence teknike
- Sherbime qeveritare
- Sherbime financiare

4.21 **Sherbimet e komunikacionit** mbulojne dy kategori kryesore te transaksioneve nderkombetare te komunikacionit ndermjet rezidenteve dhe jorezidenteve: i. telekomunikacioni, i cili perfshin transmetimin e zerit, figures, ose informacione me telefon, teleks, telegram, satelit, etj, si dhe sherbimet e rrjetit te biznesit; ii. sherbimet postale, te cilat perfshijne marrjen, transportimin dhe shperndarjen e letrave, gazetave, periodikeve, broshurave, pakove etj, nga administrata kombetare postare dhe operues te tjere. Per llogaritjen e te ardhurave dhe sherbimeve te komunikacionit sherben Formulari Nr. 8, qe plotesohet rregullisht cdo 3-mujor nga Instituti i Statistikes (Burimi i te dhenave: i. Telekom, ii. Drejtoria e Pergjithshme e Postave, iii A.T.Sh., iv. R.T.SH., Bankat).

4.22 **Sherbimet e asistences teknike** mbulojne te gjitha transaksionet e ndihmes ne forme asistence nga qeverite, institucionet dhe njesite e huaja te ndihmes dhe bashkepunimit. Burimi i informacionit Keshilli i Ministrave.

4.23 **Sherbimet qeveritare** mbulojne te gjitha transaksionet ne sherbimet qeveritare (perfshire ketu ato te organizatave nderkombetare) qe nuk jane permendur me lart. Perfshihen ketu te gjitha transaksionet e kryera nga ambasadat, konsullatat, njesite ushtarake me rezidentet e ekonomise ne te cilen keto njesi jane vendosur, si dhe te gjithe transaksionet me ekonomite e tjera. Transaksionet e kesaj kategorie perfshijne ato ne mallra dhe sherbime (sic jane pajime zyre, furnizime, lende djegese, automjete, mirembajtje e tyre etj) dhe shpenzimet personale te bera nga diplomatet, stafi konsullor dhe vartesit e tyre ne ekonomite ne te cilat jane vendosur. Gjithashtu ne kete kategori perfshihen transaksione si me siper te kryera nga njesi te tjera zyrtare (si misione ndihme e vizitore qeveritare, zyra informacioni e promocioni) te vendosura ne ekonomite e tjera; transaksione qe shoqerohen me shpenzime administrative te pergjithshme, dhe te paklasifikuara diku tjeter.

Burimi i informacionit per vleresimin e shpenzimeve qeveritare eshte Ministria e Financave nepermjet Formularit Nr.9. Vleresimi i shpenzimeve te bera nga ambasadat e huaja, si dhe njesive te tjera si Fondi Monetar Nderkombetar, Banka Boterore, etj. sigurohen nepermjet Formularit Nr.11, i cili plotesohet nga Instituti i Statistikes me frekuence tremujore. Informacion suplementar jepet nga Formulari Nr.1 per Sistemin Bankar.

4.24 **Sherbime financiare**, mbulon sherbimet e ndermjetesimit financiar si dhe sherbimet ndihmese (pervec atyre te ndermartjeve te sigurimit) ndermjet rezidenteve dhe jorezidenteve. Perfshihen ketu pagesat per sherbime financiare ndermjetesimi te tilla si ato te shoqeruara me letra krediti, kambiale, linja krediti, lizing financiar si dhe transaksione te kembimeve valutore. (Per keto te fundit, spredi ndermjet normes se interesit mesatar dhe asaj te blerjes/shitjes perben

vleren e shërbimit.) Gjithashtu këtu përfshihen komisione dhe pagesa lidhur me transaksione të letrave me vlerë dhe marrëveshjet "swap", shërbime lidhur me menaxhimin e mjeteve financiare, shërbime operacionale dhe rregullimi të tregut financiar, shërbime të administrimit të letrave me vlerë, etj.

Per llogaritjen dhe vlerësimin e këtyre shërbimeve shfrytëzohen të dhënat e formulareve Nr.1 dhe Nr.2 (Pjesa C) për bilancin e pagesave

TE ARDHURAT

Hyrje

5.1 **Te ardhurat** mbulojnë dy tipe transaksionesh midis rezidentëve dhe jorezidentëve: i. ato që përfshijnë *kompensimin e punonjësve*, i cili u paguhet punonjësve jorezidentë (punonjës sezonale, kufitare dhe të tjera që punojnë për një periudhë afat-shkurter) dhe ii. ato që përfshijnë të arketueshme e të pagueshme nga investimet në mjete dhe detyrime të huaja financiare. Këto të fundit përfshijnë të ardhura dhe pagesa nga *investime direkte, investime portofoli, investime të tjera dhe të ardhura nga mjete të rezervës*. Te ardhurat e siguruar nga përdorimi i mjeteve fizike nuk përfshihen në **te ardhura**, por sipas rastit mund të trajtohen si shërbime të tjera, shërbime transporti ose si lizing.

Fitimet dhe humbjet e kapitalit nuk klasifikohen si të ardhur nga investimet por si pjesë e vlerës së investimeve. Te gjitha këto fitime dhe humbje regjistrohet në **llogarinë financiare**.

Perkufizimi dhe klasifikimi

5.2 **Kompensimi i punonjësve** përfshin pagën, shpërblimet dhe përfitime të tjera, të fituara nga individët jorezidentë në një ekonomi, për punën e kryer për rezidentet e kësaj ekonomie.

Perfshihen ne kete kategori edhe pagesat e bera nga punedhensit ne emer te punetoreve per kontribute sigurimesh apo fonde pensioni qe perfaqesojne perfitime per punonjesit.

Ne kete kategori punonjesish, perfshihen punonjesit sezonale apo ata qe punesohen per nje periudhe afat-shkurter (me pak se nje vit), si dhe punetoret kufitare te cilet e kane qendren e interesit te tyre ekonomik ne vendin e tyre te origjines.

5.3 Meqenese ambasadat dhe konsullatat konsiderohen si njesi jorezidente ne ekonomite ne te cilat jane vendosur, kompensimi (paga, shperblimet dhe perfitime te tjera) i marre nga personeli vendas (i vendit prites) i punesuar ne keto institucione klasifikohet si pagese qe jorezidentet u bejne rezidenteve.

5.4 Shpenzimet personale te bera nga punonjesit sezonale dhe kufitare, ne ekonomite ne te cilat ata punojne rregjistrohen ne zerin *Udhetime*. Taksat, gjobat, fondet e sigurimeve shoqerore te paguara nga punonjesit ne keto ekonomi rregjistrohen si transferta korrente.

5.5 Ne bilancin tone te pagesave keto rregjistrime per kompensime dhe shpenzime paraqiten bruto gje qe rekomandohet dhe nga Manuali i Bilancit te Pagesave. Llogaritja e ketij zeri bazohet ne te dhenat e Ministrise se Punes dhe Emigracionit (numri i punonjesve shumezuar me pagen mesatare) per punetoret shqiptare me kontrata te rregullta pune, qe punesohen jashte per nje periudhe me te shkurter se nje vit. Perfshihen ketu edhe pagat e stafit vendas te ambasadave, bazave ushtarake dhe njesive qeveritare te huaja, informacioni qe sigurohet nga formulari Nr. 11 per Njesite e Huaja Diplomatike dhe Organizatat Nderkombetare.

Te ardhurat nga investimi

5.6 Kjo kategori mbulon te ardhurat qe rrjedhin nga pronesia e njesive rezidente mbi mjetet e huaja financiare. Tipet me te zakonshme te te ardhurave nga investimet jane: i. te ardhurat nga kapitali (dividenti) dhe ii. te ardhurat nga borxhi (interesi). Dividenti perfaqeson fitimin e shperndare aksionisteve ne perqindje me kontributin e tyre ne kapitalin e shoqerise. *Ai perfaqeson nje te ardhur te pagueshme pa nevojen e nje marreveshje te lidhur midis kreditorit dhe debitorit.* Lloje te tjera te te ardhurave nga kapitali mund te permendim te ardhurat nga deget dhe ndermarrje te tjera (unincorporated) te investimit direkt. Interesi perfshin te ardhura nga hua dhe letra me vlere te borxhit. Interesi paguhet mbi bazen e nje marreveshje ndermjet kreditorit dhe debitorit.

Te ardhurat nga investimet klasifikohen ne :

- interesat mbi rezervat
- te ardhura te tjera nga investimet
- te ardhura nga kapitali

Interesat mbi Rezervat

5.7 Interesat mbi rezervat mbulojne te ardhura te arketueshme dhe te pagueshme nga interesat mbi rezervat ne mjete valutore te investuara ne formen e depozitave respektivisht nga njesite rezidente jashte dhe nga njesite jorezidente ne institucionet financiare rezidente. Si burim

informacioni per vleresimin e *interesave mbi rezervat* sherbejne Formularet Nr. 2 dhe Nr. 3 qe plotesohen periodikisht cdo muaj, perkatesisht nga bankat e nivelit te dyte dhe nga Banka e Shqiperise.

Te Ardhura Kapitali

5.9 Dy kategorite e te ardhurave - te ardhura nga kapitali dhe te ardhura nga borxhi - mbulojne te ardhurat qe nje investitor direkt rezident ne nje ekonomi, siguron nga pronesia mbi kapitalin e investuar ne nje ndermarrje te nje ekonomie tjeter.

5.10 Te ardhurat nga kapitali ndahen ne: i. te ardhura qe shperndahen (dividenti dhe fitimi i shperndare i degeve) ii. fitimi i riinvestuar. Fitimi i destinuar per t'u shperndare mund te jete ne formen e dividendit mbi aksione te zakonshme apo preferenciale te zoteruara nga investitoret direkte ne ndermarrje te asociuara jashte ose anasjelltas. Fitimi i riinvestuar permban pjesen e fitimit, ne proporcion me kapitalin e zoteruar qe ndermarrjet "subsidiary" dhe "associate" (shih Investimet Direkte) nuk e shperndajne si dividend dhe ate qe deget dhe ndermarrje te tjera nuk ua shperndajne investitoreve te tyre.

5.11 Te ardhurat nga borxhi konsistojne ne interesin e pagueshem investitoreve direkte nga ndermarrje te asociuara.

Te Ardhura te Tjera nga Investimet

5.8 Te ardhura te tjera nga investimet mbulojne arketime dhe pagesa nga interesat respektivisht mbi te gjitha *pretendimet* (mjetet) dhe *detyrimet* ndaj **jorezidenteve**, qe nuk jane perfshire ne zerat e tjere. Ne kete kategori perfshihen gjithashtu te ardhurat nga *sigurimi i jetes* dhe *fondet e pensionit*.

Koha e Rregjistrimit te te Ardhurave nga Investimi

5.12 Dividentet rregjistrohen ne daten kur ato paguhet. Te ardhurat nga interesi rregjistrohen ne momentin e maturimit (accrual basis). Ne rastet kur interesi nuk paguhet ne momentin e maturimit, rregjistrimi i te ardhurave behet nen zerin *perkates* te **llogarise korrente** dhe rregjistrimi ekuivalent i tij behet ne **llogarine financiare** ne zerin "*ndryshime neto ne detyrimet/pretendimet e prapambetura*".

5.13 Per letrat me vlere me kupon zero si dhe per lloje te tjera letrash me vlere, diferenca midis cmimit te leshimit te tyre dhe vleres se maturimit (face value) trajtohet si interes. Keto interesa nuk do te rregjistrohen ne bilanc ne momentin qe maturohen per t'u paguar, por si nje seri interesash korrente pergjate gjithe jetes se letres me vlere.

Nese keto letra me vlere trajtohen perpara maturimit te tyre ne tregun sekondar, perqindjet mbizoteruese qe reflektojne diferencen midis koshtes se zoteruesve te rinj dhe vleres se maturuar do te duheshin te perdoreshin si *interesa* per rregjistrimin e tyre. Permbushja e kesaj kerkese mund te jete e veshtire. Rastet e permendura me siper jane trajtuar vetem teorikisht, ato nuk

gjejne zbatim ne praktike per vete faktin se deri me sot ne Shqiperi nuk kane ekzistuar investimet e portofolit (*Shih Investimet e Portofolit, Kap. Investimet*).

5.14 Fitimet e riinvestuara te ndermarrjeve te investimit direkt rregjistrohen ne bilancin e pagesave ne momentin e realizimit te tyre. Fitimet e shperndara te degeve dhe ndermarrjeve te tjera (unincorporated) rregjistrohen ne kohen e transferimit te tyre.

5.15 Te dhenat e perdorura per llogaritjen e kredise dhe debise se *te ardhurave nga investimi* jane vleresime te bazuara ne vrojtimit e bera nga Instituti i Statistikes. Rezultatet e ketyre vleresimeve paraqiten ne menyre te permbledhur ne Formularin Nr.14 *per ndermarrjet jobankare* qe plotesohet me frekuence tremujore. Si burim suplementar informacioni mund te sherbeje dhe Formulari Nr.1 nga bankat tregtare.

TRANSFERTAT KORRENTE DHE KAPITALE

Transfertat - veshtrim i pergjithshem

Perkufizim

6.1 **Transferta quhen gjithë rregjistrimet balancuese per burimet reale dhe zerat financiare, qe nje ekonomi i siguron nje ekonomie tjeter pa marre per keto nje vlere te barabarte ne kthim.** Kjo nenkupton qe kur nje ekonomi e dhene nuk merr nje shperblim ne forme burimi real ose mjeti financiar per mallra, sherbime, te ardhura, ose zera financiare qe kjo i ofron nje ekonomie tjeter, ose anasjelltas, kur nje ekonomi nuk jep shperblim per mallrat, sherbimet, te ardhurat ose zerat financiare te siguruara nga nje ekonomi tjeter, bilanci i pagesave do te rregjistroje nje transferte. Bilanci i pagesave do te rregjistroje si transferta gjithashtu edhe rritjen apo zvogelimin ne burime reale apo zera financiare qe lindin nga migrimi.

6.2 Ne qofte se burimet reale apo mjetet dhe detyrimet financiare rriten apo zvogelohen per shkak te ndryshimeve ne territorin gjeografik te nje vendi, keto ndryshime nuk do te paraqiten ne statistikat e bilancit te pagesave.

Dallimi Ndermjet Transfertave Korrente e Kapitale

6.3 Rregjistrimi i nje transferte ne statistikat e bilancit te pagesave kerkon para se gjithash nje dallim te qarte ndermjet transfertave kapitale dhe atyre korrente.

6.4 Transfertat kapitale konsistojne ne: i. transferimin e pronesise se nje mjeti fiks, ose ii. ne faljen e nje detyrimi nga nje kreditor. Nje transferte ne kesh konsiderohet si transferte kapitale kur eshte e lidhur me, apo i kushtezuar nga **fitimi ose dhenia e nje mjeti fiks** (ndihmat me karakter investimi) nga njera apo te dy palet pjesmarrese ne transakcion. Me marreveshje transfertat e migranteve konsiderohen gjithashtu transfertat kapitale.

6.5 Transferta korrente konsiderohen te gjitha transfertat qe nuk jane transfertat kapitale. Transfertat korrente ndikojne drejtepersedrejt ne nivelin e te ardhurave te disponueshme dhe do te influencojne keshtu edhe ne konsumin e mallrave dhe sherbimeve, d.m.th transfertat korrente reduktojne te ardhurat dhe mundesite e konsumit te donatorit duke rritur te ardhurat dhe mundesite e konsumit te marresit.

6.6 Disa transfertat ne kesh mund te trajtohen si kapitale nga njera pale dhe korrente nga pala tjeter. Per te shmangur trajtimin e te njejtit transakcion ne menyra te ndryshme nga marresi dhe dhuruesi, **Manuali** rekomandon qe nje transferte ne kesh te klasifikohet si kapitale per te dy palet palet madje edhe kur transfertat eshte e lidhur me fitimin apo dhenien e nje mjeti fiks vetem nga njera prej paleve. Nga ana tjeter, nese ekzistojne dyshime serioze qe nje transferte ne kesh duhet te klasifikohet si transferte kapitale, **Manuali** rekomandon qe transfertat te rregjistrohet si transfertat korrente.

Vleresimi

6.7 Meqenese transfertat perkufizohen si rregjistrime ballancuese per burimet reale ose zerat financiare, vlera e transfertave te njeaneshme duhet te jete e njejte me ate te burimeve financiare e reale kundervlere e te cilave ato jane. Transfertat duhet te vleresohen me cmimin sundues te tregut per burimet e transferuara. Ne mungese te ekzistences se nje cmimi te tille, burimet reale te transferuara do te vleresohen ne lidhje me koston e prodhimit apo fitimit te tyre nga donatori.

Koha e rregjistrimit

6.8 Parimisht, transfertat rregjistrohen ne momentin kur burimet te cilat ato balancojne, ndryshojne pronesi. Taksat, gjobat dhe transfertat te tjera korrente qe jane ngarkuar nga njera pale tjetres, rregjistrohen ne kohen kur maturohen per t'u paguar. Nese nje pagese takse eshte shtyre, ajo do te rregjistrohet ne **momentin kur maturohet per t'u paguar** dhe jo kur eshte paguar vertet, njekohesisht behet nje rregjistrim balancues ne **llogarine financiare** per te treguar detyrimin e papaguar ne afat.

TRANSFERTAT KORRENTE

Ne klasifikimin e komponenteve standarte (te treguar ne Manual), transfertat korrente paraqiten te ndara ne tre grupe: 1. Ndhima shteterore nga jashte (transfertat shteterore), 2. Dergesa nga te catdhesuarit dhe 3. Te tjera.

Ndihma shteterore nga jashte (Transferta shteterore)

6.9 Ndihma shteterore nga jashte i referohet transfertave korrente ndermjet sektorit shteteror rezident dhe jorezidenteve. Si i tille, ky ze perfshin transfertat korrente ndermjet qeverise se vendit hartues dhe qeverive te huaja si dhe transfertave korrente ndermjet sektorit qeveritar rezident dhe njesive joshteterore jorezidente. Nuk perfshihen ketu, transfertat korrente ndermjet nje njesie joshteterore rezidente dhe qeverive te huaja. Keto transferta klasifikohen si "transferta te tjera korrente".

6.10 Transfertat shteterore korrente perfshijne subvencione apo ndihma per buxhetin korrent (pervec kur subvencionet lidhen me shtesa te stokut te kapitalit te vendit marres), asistencen teknike, demshperblimet e ngarkuara nga traktatet e paqes, premiot e sigurimit minus pagesen per sherbimin dhe pretendimet e sigurimit mbi humbjet, kontributet qeveritare per buxhetin administrative te organizatave nderkombetare. Gjithashtu ne transfertat shteterore korrente perfshihen, ne kredi, taksa, gjoba dhe biletat e shitura nga qeveria ne llotari te sponsorizuara prej saj; dhe ne debi, bursa dhe ndihma te tjera per training dhene jorezidenteve per te financuar edukimin e tyre ne vendin e donatorit ose jashte, rikthimi i shumave te paguara si taksa, pagesa per anetaresi ne organizatat joqeveritare, ndihma per njesite joqeveritare, pensione jokontraktore e perfitime te tjera, si dhe cmime te fituara nga llotarite e sponsorizuara nga qeveria.

Shkembimi i ndihmave ndermjet sektoreve qeveritare te dy ekonomive ne nje periudhe te dhene duhet te rregjistrohet ne baze bruto.

6.11 Persa i perket taksave, duhet pasur parasysh se, taksat e perfituara mbi pronen e zoteruar nga nje jorezident, nuk perfaqesojne nje transferte, por taksa te pagueshme nga "ndermarrja rezidente" imagjinare e cila supozohet te jete zoteruese e pasurise. Si te tilla, keto taksa perfaqesojne transaksione midis rezidentesh dhe nuk do te paraqiten ne bilancin e pagesave megjithese ato ndikojne mbi te ardhurat e investimeve direkte te atribueshme pronarit jorezident te ndermarrjes se imagjinuar.

6.12 Ne lidhje me asistencen teknike, kostoja totale e asistences se ofruar, duke perfshire kostot ne vendin donator, duhet te rregjistrohet si transferte korrente. Ne baze te udhezimeve te Manualit te Bilancit te Pagesave, prodhimi i shoqeruar me asistencen teknike i atribuohet ekonomise marrese dhe jo asaj donatore. Kjo do te thote qe burimet e konsumuara ne sigurimin e asistences teknike do te duhej te trajtoheshin si burime te fituara nga ekonomia marrese.

Ndihmat shteterore nga jashte klasifikohen me tej ne tre nengrupe:

- Asistencen teknike
- Ndihma ne kesh
- Mallra dhe ndihma te tjera

Ndihmat shteterore nga jashte vleresohen mbi bazen e te dhenave te raportuara nga Keshilli i Ministrave ne Formularin Nr. 16 per Bilancin e Pagesave. Paralelisht me formularin e Keshillit te Ministrave per sigurimin e te dhenave mbi ndihmat shteterore nga jashte shfrytezohen dhe burime paralele informacioni: i. Formulari Nr. 12 (pjesa B) siguron informacion suplementar nga Sistemi

Bankar per *ndihmat ne kesh*. ii. Tabela Nr. 3 (nga Doganat) trajton si ze te vecante *ndihmat ne mallra*.

Ashtu sic u permend edhe me lart, ne zerin *Mallra dhe ndihma te tjera* perfshihen gjithashtu edhe te ardhurat nga taksat portuale e kufitare. Te dhenat e nevojshme sigurohen nga Formulari Nr. 15 per Bilancin e Pagesave dhe Tabela Nr. 1 "Te ardhurat per muajin" e perpiluar nga Drejtoria e Pergjitheshme e Doganave.

Dergesat e te catdhesuarve (punonjesve)

6.13 Dergesat e te catdhesuarve i referohen transfertave te migranteve (te cilet jane punesuar ne ekonomi te tjera), derguar rezidenteve te ekonomise se meparshme. Transfertat mund te lidhen me transfertat e mallrave ose te zerave financiare. Megjithate, nese nje migrant dergon para per t'i depozituar ne llogarine e tij bankare jashte, transaksioni nuk perfaqeson nje transferte, por nje investim financiar per t'u rregjistruar keshtu ne **llogarine financiare**.

6.14 Dergesat e te catdhferohen vetem transfertave tejesve, te cilet qendrojne ne nje vend te huaj te pakten nvend te huaj te pakten nje vit (migrantet). Nese punonjesit qendrojne me pak se nje vit ata konsiderohen si jorezidente te ekonomise mikpritese dhe transfertat derguar ne vendin e tyre perfaqesojne shperndarje te **te ardhurave nga puna** te fituara nga nje punonjes i huaj.

6.15 Dergesat e te catdhesuarve i referohen vetem transfertave te atyre migranteve te cilet jane te punesuar nga nje njesi ekonomike ne vendin mikprites, ku ata konsiderohen rezidente. Nese nje migrant zhvillon biznesin e tij ne ate vend, d.m.th. nese ai eshte i vetepunesuar, transfertat e tij jashte nuk klasifikohen si dergesa nga te catdhesuarit, por si transferta te tjera korrente. Ky dallim eshte bere sepse me marreveshje, dergesat e te catdhesuarve konsiderohen se marrin forme pune jo te ardhure.

METODIKA E LLOGARITJES SE DERGESAVE NGA MIGRANTET

Menyra normale e llogaritjes se influkseve te valutes "cash" nga te catdhesuarit (kryesisht migracioni) do te ish ajo e evidentimit te tyre ne pikat kufitare. Por me sistemin e sotem doganor dhe me nivelin e zhvillimit aktual, te besosh ne nje sistem deklarimi te valutave ne pikat doganore eshte praktikisht idealizem.

Flukset e valutave qe hyjne kryesisht nga kufiri dhe permes sistemit bankar, shfaqen ne tregjet e kenbimeve valutore ku konvertohen ne leke ose ruhen ne formen e kursimeve. Me perjashtim dergesave te kanalizuar permes bankes flukse te tjera hyrese jane praktikisht te pamatshem statistikisht sepse ne pergjithesi e gjithe valuta konvertohet per leke ne tregun paralel qe ka kurse me konkruese. Duke djekur hap pas hapi levizjen e ketij cash-i valutor (GRD, DEM, SFR, ITL, etj) u konstatua se hapi pasardhes dhe pikerisht dalja e ketyre monedhave nga tregu paralel, mund te evidentohet pjeserisht me saktesi per te financuar importin e mallrave dhe sherbimeve si dhe rritjen e mjeteve financiare. Nga nje analize e thjeshte del qarte se flukset dalese mund te evidentohen pjeserisht me saktesi dhe pjeserisht me vleresime duke perdorur edhe burime suplementare informacioni.

Pra metodika e vleresimit te dergesave nga emigrantet bazohet ne matjen e flukeve dalese te valutes nga tregu paralel (sepse dergesat ne permjet sistemit bankar jane automatikisht te matshme).

Kjo metodike bazohet ne dy supozime kryesore:

- Se pari per te konsumuar te mira, mallra e sherbime, ne tregun shqiptar familjeve te emigranteve u duhet te shpenzojne leke e jo valute te huaj.
- Se dyti meqenese kemi nje regjim fleksibel te kembimit, ku cmimi i valutes vendoset ne treg, tregu i kembimeve valutore eshte gjithmone ne ekuiliber.

Kjo do te thote se me nje afersi te besueshme, cdo dite ajo sasi valute qe hyn ne treg del nga tregu. Bazuar ne keto arsytetime mund te themi se duke matur flukset dalese te valutes nga tregu paralel masim me afersi te besueshme sasime e valutes cash qe hyn ne treg. Per rrjedhim jemi perpjekur te ndertojme nje matrice te flukseve te valutes qe evidenton flukset dalese dhe ato hyrese te valutes ne cash nga tregu paralel. Ne parim ne flukset hyrese perfshihet e gjithë valuta qe hyn ne treg dhe qe nuk perfaqeson dergesa nga emigrantet. Diferenca ndermjet flukseve dalese dhe atyre hyrese perfaqeson dergesat nga emigrantet. Kjo shifer pasi i shtohet edhe totali i dergesave (transfertat) nga jashte-brenda nepermjet bankave tregtare (me ane cekash e urdherderdhjesh) paraqitet si vleresim per dergesat nga emigrantet.

Transferta te tjera

6.22 Ky ze i referohet transfertave korrente, pervec atyre qe perfshihen ne dergesat e te catdhesuarve, ku njesia rezidente nuk eshte pjese perberese e sektorit qeveritar. Si i tille, ky ze permban transferta ndermjet njesive rezidente joqeveritare dhe atyre jorezidente joqeveritare. Keto perfshijne dhurata, trashegimi, dhe dergesa te tjera ndihme; biletat e shitura dhe cmime te fituara nga llotari joqeveritare; kontribute dhe pensione nga fonde pensioni tregtare; pensione jokontraktore nga agjensi joqeveritare, premiot e sigurimit (jojetesor) ne raste fatkeqesish minus pagesen per sherbimin si dhe pretendimet mbi sigurimin (jojetesor) ne keto raste; ndihma, pervec investimeve-ndihma; kontribute dhene per qellime fetare, shkencore, kulturore, organizatave te karitasit; pagesa per anetaresi ne shoqeri pa qellim fitimi. Gjithashtu ne transferta te tjera korrente perfshihen, ne kredi, bursa dhe ndihma te tjera te ngjashme per trainimin praktik perfituar (akorduar) nga qeverite e huaja me qellim financimin e edukimit te tyre ne vendin e donatorit ose jashte, taksa te shtyra dhe pensione jokontraktore si dhe perfitime te tjera nga qeveri te huaja; dhe ne debi, taksa, gjoba dhe pagesa per rregjistrimin e transportuesve bere qeverive te huaja.

6.23 Transfertat ne emer te rezidenteve te nje ekonomie te cilet ndodhen jashte saj per nje periudhe me te shkurter se nje vit si p.sh dergesa nga prinderit per femijet e tyre gjate qendrimit jashte shtetit, perfaqesojne transaksione ndermjet rezidenteve te se njejtës ekonomie dhe duhen perjashtuar nga evidencat e bilancit te pagesave te asaj ekonomie. Ne te kundert, shpenzimet e bera jashte nga rezidente qe qendrojne me pak se nje vit ne nje vend te huaj, duhet te rregjistrohen si shpenzime udhetimi.

Si burim te dhenash per vleresimin e *transfertave te tjera* sherben formulari Nr. 1 qe plotesohet cdo 10 dite nga bankat e nivelit te dyte.

TRANSFERTAT KAPITALE

6.24 Ne listen e komponenteve standarte ashtu si dhe transfertat korrente, transfertat kapitale ndahen ne nenkomponente: qeveria e pergjithshme dhe te tjera.

6.25 Transfertat shteterore kapitale ndahen me tej ne: borxhin e falur dhe transferta te tjera. Ndersa transfertat joqeveritare, ndahen ne transfertat e migranteve, borxhi i falur dhe ne te tjera. Kriteret e percaktimit kur nje transferte kapitale do te duhej te rregjistrohej ne transfertat shteterore ose ne transferta te tjera, jane te ngjashme me ato per te dalluar transfertat shteterore korrente nga transfertat e tjera.

Ne vazhdim, do te diskutojme transfertat kapitale ne baze te tipeve te transfertave dhe jo sipas sektoreve te cileve u akordohen.

Borxhi i falur

6.26 Ne lidhje me faljen e borxhit, vetem anulimet e bazuara ne marreveshje perfaqesojne transferta kapitale; shuarja e borxhit reflekton nje humbje kapitali i cili nuk duhet te rregjistrohet si transferte. Burimi i informacionit eshte formulari Nr. 12.

Transfertat e migranteve

6.27 Migrantet perkufizohen ne Manual si individe - pervec diplomateve, ushtarakeve, ose personelit tjetër te nje qeverie, studente, ose paciente - te cilet largohen prej vendit te tyre ne drejtim te nje vendi tjetër dhe qendrojne atje te pakten per nje vit.

6.28 Transfertat e migranteve i referohen pasurive personale, sebashku me pretendimet e detyrimet financiare, qe ata i transferojne gjate migrimit ne nje vend tjetër. Ne kuptimin e ngushte, keto transferta nuk jane transferta ndermjet dy paleve, por jane rregjistrime ballancuese per flukset e mallrave dhe ndryshimet ne zerat financiare qe lindin nga akti i migrimit. Keto rregjistrime (ne vlere) jane te barabarta me pasurine neto te migranteve.

6.29 Vlera e pasurise personale te migranteve sebashku me te mirat kapitale te levizshme qe jane transferuar aktualisht, rregjistrohen si transaksione ne **mallra** me rregjistrime ballancuese nen transfertat e migranteve. Pretendimet dhe detyrimet financiare te migranteve ne vendin e tyre te meparshem te rezidences, si p.sh depozita bankare, aksione, bono dhe hua te dhena (marra), duhet te rregjistrohen nen komponentet e ndryshem te **llogarise financiare** me rregjistrime ballancuese nen transfertat e migranteve. Vendi dhe pasurite e patundshme te zoteruara nga migrantet ne vendin e tyre te meparshem si dhe te mirat kapitale te levizshme qe nuk jane transferuar duhet te trajtohen *lidhur me marreveshjen e bere ne Manual*, sikur ata kane ndermarre investime financiare ne nje "**ndermarrje**" qe i zoteron keto mjete. Ne bilancin e pagesave te vendit ne te cilin migrantet kane migruar, investimet financiare duhet te rregjistrohen si rritje ne kapitalin e investimeve direkte me nje hyrje ballancuese nen transfertat e migranteve. Pretendimet dhe detyrimet e migranteve ndaj rezidenteve te vendit ne te cilin ata migrojne kthehen ne pretendime e detyrime ndermjet rezidenteve te se njejtës ekonomi dhe per rrjedhoje ne bilancin e saj te pagesave, ndryshimi i rezidences duhet te trajtohet sikur keto pretendime e detyrime kane qene paguar.

Transferta te tjera kapitale

6.30 Transferta te tjera kapitale lidhen kryesisht me investimet ndihma. Keto investime ndihma perdoren per qellime te shiteses ose te financimit te formimit te kapitalit fiks te ekonomise perfituese. Per shembull, financime te siguruara nepermjet nje programi te huaj ndihme per ndertimin e nje dige, do te konsiderohet si investimet ndihma.

6.31 Ndhima te pergjithshme bere njesive te huaja qeveritare te cilat mund te perdoren per cdo qellim tjeter pervec financimit te investimeve, duhet te rregjistrohen si transferta korrente. Ashtu si investimet ndihma, ato te trasheguara, taksat e falura si dhe taksa te tjera ne transfertat e mjeteve apo pagesa te kompensimeve, (pervec atyre qe rezultojne nga pretendime sigurimi) identifikohen si transferta kapitali.

6.32 Ne dallim nga klasifikimi i zerave standarte te bilancit te pagesave te Manualit te botuar nga Fondi Monetar Nderkombetar, ne Bilancin Shqiptar te Pagesave transfertat kapitale rregjistrohen **neto** ne zerin **transferta kapitale ne llogarine financiare**.

INVESTIMI DIREKT

Koncepte dhe karakteristika

7.1 Investimi direkt eshte kategoria e investimeve nderkombetare ne te cilat nje njesi rezidente synon sigurimin e nje interesi te qendrueshem ne nje ndermarrje te nje ekonomie tjeter. (Njesia rezidente eshte investitori direkt dhe ndermarrja eshte nje ndermarrje e investimit direkt). Koncepti i interesit te qendrueshem nenkupton ekzistencen e nje marredhenieje afat-gjate midis investitorit direkt dhe ndermarrjes si dhe te nje influence te konsiderueshme te investitorit ne menaxhimin e ndermarrjes. Investimi direkt nuk perfshin vetem transaksionin fillestar te vendosur midis investitorit dhe ndermarrjes por dhe te gjithe transaksionet pasuese midis tyre.

Ndermarrjet e Investimit Direkt

7.2 Ndermarrja e investimit direkt perkufizohet si nje ndermarrje ne te cilen investitori direkt (rezident i nje ekonomie tjeter) zoteron 10 perqind ose me shume te aksioneve te zakonshme ose te fuqise votuese. Ndermarrjet e investimit direkt perfshijne: i. subsidierit (nje jorezident zoteron me shume se 50 perqind te kapitalit te ndermarrjes), ii. ndermarrjet e asocoiuara (nje investitor zoteron 50 perqind ose me pak te kapitalit) dhe iii. degjet (branches), qe zoterohen direkt ose indirekt nga investitori direkt.

Investitoret Direkte

7.3 Investitoret direkte mund te jene individe; ndermarrje private ose shteterore; grupe individesh apo ndermarrjesh; qeveri ose agjensi qeveritare; ose shoqeri, truste apo organizata te

tjera qe zoterojne (sic eshte pershkruar me lart) ndermarrje te investimit direkt ne ekonomi te tjera ku ky investitor nuk eshte rezident. *Pjesetaret e nje grupi te bashkuar individesh ose ndermarrjesh qe sebashku zoterojne 10% ose me teper te kapitalit kane mbi drejtimin nje influence te ngjashme me ate te nje individi me te njejten shkalle pronesia.*

Kapitali i Investimit Direkt

7.4 Kapitali i investimit direkt eshte i. kapitali i investuar nga nje investitor ne nje ndermarrje te investimit direkt ose ii. kapital i investuar nga nje investitor nepermjet nje ndermarrjeje te investimit direkt. Per ekonomine ne te cilen eshte bere investimi, kapitali perfshin fonde te investuara nga vete investitori, ose fonde te investuara nga ndermarrje te tjera te investimit direkt te te njejtit investitor. Per ekonomine e investitorit direkt, nje kapital i tille perfshin vetem fonde te investuara nga investitori rezident ne nje ekonomi jorezidente.

7.5 Transaksionet e investimeve direkte perfshijne transaksionet e krijimit apo te shperberjes se investimit si dhe ato per mbajtjen, zgjerimin ose reduktimin e tij. Keshtu ne rastin kur nje jorezident i cili paraprakisht nuk ka kapital ne nje ndermarrje ekzistuese rezidente, blen nga nje rezident 10 % apo me teper te aksioneve apo te "fuqise votuese" te kesaj ndermarrjeje, vlera e tregut e aksioneve te blera dhe e cfaredo kapitali tjeter te investuar duhet te rregjistrohet si investim direkt.

N.q.s. nje jorezident zoteron fillimisht me pak se 10 % te aksioneve te nje ndermarrjeje ne formen e nje investim portofoli dhe me pas blen aksione te tjera duke e kthyer investimin e tij ne nje investim direkt (pra zoteron te pakten 10%), atehere si transaksion i investimit direkt do te rregjistrohet vetem blerja e ketyre te fundit. Aksionet e zoteruara me pare nuk rregjistrohen ne bilancin e pagesave, *por reflektohen ne klasifikim, ne pozicionin nderkombetar te investimeve, nga investim portofoli ne investim direkt.*

Vleresimi i Flukseve dhe i Stokut

7.6 Flukset dhe stoqet e investimeve duhet te vleresohen me cmimin e tregut, megjithate ne Manual, pranohet qe vlera e stokut te investimeve direkte te vleresohet duke u bazuar ne "*librat e llogarive*" (*bilancet*) te ndermarrjeve te investimit direkt (ose te investitorit). Kjo praktike reflekton faktin, qe vlerat e bilancit te ndermarrjes - pavaresisht nese rivleresohen rregullisht me vlerat korrente te tregut, rregjistrohen ne baze te kostove historike, apo bazohen ne rivleresime te perkoheshme - paraqesin te vetmin burim vleresimi menjehere te disponueshem te mjeteve dhe detyrimeve ne shumicen e vendeve. Mbledhja e te dhenave nga ndermarrjet ne baze te vleres korrente te tregut inkurajohet me qellim qe te zvogeloje hendekun midis teorise dhe praktikese. Vleresimi dhe rregjistrimi i transaksioneve ne investime direkte ne bilancin tone te pagesave behet ne perputhje te plote me rregullat dhe rekomandimet nderkombetare.

Si burim informacioni per vleresimin e flukseve te investimeve sherbejne: Instituti i Statistikes, Agjensia per Nxitjen e Investimeve te Huaja.

INVESTIMET E PORTOFOLIT

8.1 Investimet e portofolit përfshijnë, në shtesë të letrave me vlerë të pasurisë (aksionet) dhe të borxhit në formën e obligacioneve dhe kambialeve, instrumentat e tregut monetar dhe derivatet financiare siç janë opsionet. Përfshihen nga investimet e portofolit instrumentat e mesipër që klasifikohen në investimet direkte ose mjete të rezervës. Përfshirja në këto kategori të gjithmone e me shumë transaksioneve ka ardhur si pasojë ndryshimeve në tregjet ndërkombëtare financiare në vitet e fundit dhe prezantimit të shumë instrumentave të rinj financiar.

8.2 Në dallim nga kategoritë e tjera të llogarive financiare, investimet e portofolit nuk ndahen në investime afat-gjate dhe afat-shkurter. Fakti se maturimi origjinal po bëhet gjithnjë e më pak i rëndësishëm për shumë pjesëmarrës në tregjet monetare, aktivitetet e investimeve dhe të huadhenies ka pasur si rezultat përfshirjen e instrumentave të reja shtesë brenda investimeve të portofolit. Skema e klasifikimit të kësaj kategorie reflekton zhvillimet në tregjet financiare dhe përpjekjet për të përmirësuar lidhjet me llogaritë kombëtare dhe sistemet e tjera statistikore të Fondit Monetar Nderkombëtar.

Klasifikimi dhe përcaktimet.

8.2 Kategoritë e instrumentave financiar të përcaktuara dhe klasifikuara në manual janë përgjithësisht në përputhje të plote me konceptet e përdorura në Llogaritë Kombëtare. Komponentet me të rëndësishëm të investimeve të portofolit të klasifikuara në mjete të detyrime janë letrat me vlerë të pasurisë (aksionet) dhe letrat me vlerë të borxhit të tregtueshme në tregjet financiare. Letrat me vlerë të borxhit ndahen me tej në obligacione dhe kambiale, instrumenta të tregut monetar, derivate financiare që përfshijnë një game të gjere instrumentash të rinj financiar.

8.3 Letrat me vlerë të pasurisë (aksionet) janë instrumenta që i njohin zotëruesit pretendimin për një vlerë të mbetur ose për një të ardhur të mbetur kundrejt ndermarjes emetuese pasi janë paguar pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë. Aksionet ose dokumenta të tjerë të ngjashme zakonisht shprehin pronesi mbi pasurinë. Gjithashtu si letra me vlerë të pasurisë do të klasifikohen dhe aksionet e preferuara të cilat i japin zotëruesit të drejtën e pjesëmarrjes në shpërndarjen e fitimit ose në shpërndarjen e vlerës së mbetur në rastin e likuidimit të ndermarjes. Megjithatë aksionet e preferuara që i njohin zotëruesit të drejtën e një vlerë fikse në momentin e maturimit, kur kjo është e pavarur nga fitimi që ka realizuar ndermarja emetuese nuk duhet të konsiderohen si letra me vlerë të pasurisë. Sygjerohet që transaksionet në këto instrumenta të klasifikohen si obligacione dhe kambiale.¹

8.4 Pronesia e fondeve të investimeve (mutual funds), trustet e investimeve dhe investime të ngjashme me to përfaqësojnë gjithashtu investime në pasuri (në varesi të llojit të investimit të bërë nga fondi ose nga trusti).

8.4 Letrat me vlerë të borxhit mbulojnë (i) obligacionet, obligacionet e paguarantuar, kambialet, etj; (ii) instrumentat e borxhit të negociueshëm ose të tregut monetar dhe (iii) derivatet financiare ose instrumentat sekondar siç është opsioni që zakonisht nuk zgjeron sjelljen aktuale dhe përdoren për t'u mbrojtur nga rreziku i kursit të kembimit, investime, dhe për qëllime tregtimi.

¹ .Në rastet kur këto lloje aksionesh të preferuara emetohen me një maturim me të vogël se një vit këto duhet të regjistrohen në instrumenta të tregut monetar.

8.5 Obligacionet, obligacionet e pagarrantuara, kambialet etj, zakonisht i japin mbajtesit nje te drejte te pakushtezuar kundrejt nje shume fikse parash ose nje sasi te ndryshueshme te ardhurash, kontraktualisht te percaktuara qe nuk varen nga te ardhurat e emetuesit. Me perjashtim te obligacioneve te perjetshme obligacionet dhe obligacionet e pagarrantuara gjithashtu i sigurojne zoteruesit te drejten e pakushtezuar mbi nje shume fikse si ripagim i principalit ne nje date, ose ne data te percaktuara. Ne kete kategori perfshihen aksionet e preferuara, obligacionet e konvertueshme, etj. Kjo kategori gjithashtu perfshin certifikatat e negociueshme te depozitave me maturim me teper se nje vit, obligacione te monedhave te dyfishta, zero kuponet, obligacionet me skontim te thelle (deep discounted bonds), obligacionet e kurseve te ndryshueshme (floating rate bonds), obligacionet e indeksuara, letra me vlere te siguruara nga mjetet (asset-backed securities) sic jane obligacionet e garantuara me hipoteke dhe certifikatat e pjesemarrjes.

8.6 Letrat me vlere te tregut monetar ne pergjithesi i japin zoteruesit te drejta te pakushtezuara per te marre nje shume fikse parash ne nje date te caktuar. Keto instrumenta zakonisht tregtohen, me skontim ne tregjet e organizuara; skontimi varet nga norma e interesit dhe koha e mbetur deri ne maturim. Gjithashtu perfshihen ketu instrumenta te tille si bonot e thesarit, deftesat tregtare dhe financiare (commercial and financial papers), biletat bankare (bankers acceptances), certifikatat e depozitave te negociueshme dhe kambialet afatshkurter te emetuar nen nje marrveshje NIF. (Marreveshjet e riblerjes, te cilat nuk jane te negociueshme dhe jane te nje karakteri te ndryshem klasifikohen nen *huate* ne kategorine *investime te tjera*.)

8.7 Disa instrumenta financiar i japin zoteruesve te drejten e nje perfitimi ekonomik ne forme keshi ose nje instrumenti primar financiar etj ne nje date te caktuar. Keto instrumenta jane percaktuar si derivat ose si instrumenta sekondar per faktin se ato jane te lidhur ose me ndonje instrument financiar te percaktuar, ose me tregues te ndryshem (monedha te huaja, obligacione qeveritare, tregues te cmimeve te aksioneve, normat e interesit etj), ose ne nje mall te caktuar (ar, sheqer, kafe etj) qe mund te blihen dhe te shiten ne nje date te percaktuar ne te ardhmen. Derivatit gjithashtu mund te jene te lidhura me shkembimin e nje mjete per nje mjet tjetere ne te ardhmen, sipas nje marreveshje kontraktuale. ***Ky instrument i cili eshte nje kontrate mund te jete i tregtueshem dhe te kete nje vlere tregu.*** Ne nje rast te tille karakteristikat e instrumentit si nje mjet ose detyrim (qe nuk perbente objekt rregjistrimi per bilancin e pagesave ose per llogarite kombetare) ndryshojne, dhe kane si pasoje trajtimin e instrumentit si nje mjet ose detyrim aktual ne ***llogarine financiare***. Si derivativa mund te permendim opsionet (mbi monedhat, normat e interesit, mallrat etj) kontratat e tregtueshme te se ardhmes mbi nje instrument financiar (trade financial futures), garancite dhe marreveshjet swap te monedhave dhe normave te interesit.

Transaksionet ne derivativat trajtohen si transaksione me vete (kryesisht financiar) dhe nuk perfshihen si pjese perberese e transaksioneve me te cilat keto jane te lidhura per t'i mbrojtur keto te fundit ndaj rrezikut te kursit te kembimit, inflancionit etj.

8.8 Letrat me vlere te pasurise (aksionet) dhe letrat me vlere te borxhit me tej ndahen sipas sektoreve institucional rezidente. Ndarja e metejshme sipas sektoreve jorezident mund te jete me interes analitik ashtu sic mund te jete me interes ndarja e letrave me vlere ne emetime te reja, transaksione ne letrat me vlere ekzistuese, dhe dallimet ndermjet komponenteve te shprehura ne monedha vendase dhe te huaja.

Ceshtje te rregjistrimit

8.9 Numri gjithnjë e më i madh i transaksioneve të cilat përfshijnë instrumentat tradicionale dhe ato të reja të tregjeve monetare, dhe letrat me vlerë afat-gjate të përfshira në investimet e portofolit ngrenë një sërë pyetjesh në lidhje me regjistrimin e këtyre instrumentave në bilanci dhe pagesave. Në vazhdim do të diskutojmë këto probleme.

8.10 *Zero kuponet* (dhe të tjera obligacione me skontim të thellë) kanë një pagesë të vetme, këto janë letra me vlerë afat-gjate që nuk përfshijnë pagesat periodike të interesit gjatë jetës së obligacionit, në të kundërt obligacione të tilla shiten me një skontim nga vlera nominale e tij dhe vlera e plate paguhet në momentin e maturimit. Kështu diferenca ndërmjet cmimit të skontuar dhe cmimit të maturimit është e dukshme. Kjo diferencë është trajtuar si e ardhur nga interesi dhe rregjistrohet si një seri pagesash më të mëdha, më të mëdha ose më të mëdha gjatë jetës së obligacionit. Diferenca (të ardhurat nga interesi) nuk rregjistrohet në momentin e maturimit. (Rregjistrimet bilanciuese të të ardhurave nga interesi përfshihen në letrat me vlerë të borxhit në ***llogarinë financiare*** dhe ka efektin e interesave të riinvestuara.) Kështu kosto e sigurimit të kapitalit përputhet me koston e të cilin sigurohet kapitali. Në qoftë se një obligacion me skontim të thellë ose zero kupon është tregtuar me përparësi se të maturohet në tregun sekondar cmimi i transaksionit mund të përfshijë një fitim ose një humbje nga realizimi i pronësive në shtesë të interesit të maturuar por të papaguar (accrued interes). Ky ndryshim (fitimi ose humbja) i shkaktuar nga blerjet dhe shitjet e këtyre obligacioneve me cmimin e tregut do të rregjistrohet në ***llogarinë financiare***. Norma e interesit ekzistues që paraqet diferencën midis kostos së zotëruesve të rinj dhe vlerës së maturimit të obligacionit duhet të përdoret për rregjistrimet e mëvonshme të interesave mbi obligacionin.

8.11 *Letrat me vlerë të indeksuara* (index linked securities) janë instrumente për të cilat çdo pagesë kuponi ose e principarit është e lidhur me indeksin e një cmimi, me cmimin e një malli ose me kursin e këmbimit ose dëbës të ngjashme me të. Qëllimi është që përveç fitimit të të ardhurave nga interesi, të ruhet fuqia blerëse gjatë periudhës inflacioniste. Kur pagesat e kuponave janë të indeksuara ato trajtohen si të ardhura nga interesi ashtu si në rastin e çdo mëtej financiar që ka norma interesi të luhateshme. Kur vlera e principarit është indeksuar si principar do të rregjistrohet cmimi i emetimit të letres me vlerë dhe ndryshimi në vlerë që rezulton nga indeksimi - periodikisht dhe në momentin e maturimit - duhet të trajtohet si e ardhur nga interesi. Ndryshimi në vlerë i shkaktuar nga indeksimi duhet të vlerësohet dhe të rregjistrohet si e ardhur nga interesi për gjatë gjithë jetës së letres me vlerë dhe rregjistrimet bilanciuese do të behen në letrat me vlerë të borxhit në ***llogarinë financiare***.

8.12 Ndermjet instrumentave të tregut monetar, derivativave ekzistojnë dhe kambialet afat-shkurter të emetuar nën një marrëveshje NIF, opsionet, garancite, marrëveshjet swap, kontratat e tregtueshme të të ardhmës, marrëveshjet forward, të cilat do të trajtohen në paragrafet që vijojnë.

Një kambial i emetuar nën një marrëveshje NIF¹ (zakonisht një marrëveshje afatmesme nga 5-7 vjet) është një instrument afat-shkurter (3-6 muaj) i emetuar nga një borxhmarres në emer të tij sipas një marrëveshje kontraktuale me një bankë ose me një grup bankash ose (i) për të nënshkruar kambialet dhe blerë ndonjë kambial të pashitur për huamarrje të vecanta, apo në datën e maturimit (roll-over date); ose (ii) të sigurojë mbështetje me kredi për huamarrsin.

8.13 Sipas parimeve të rregjistrimit të bilanci të pagesave, krijimi i një marrëveshje NIF në vetvete nuk kërkon një rregjistrim në ***llogarinë financiare*** sepse marrëveshjet NIF janë të kushtëzuara. Kur kambialet janë emetuar dhe shitur nën një marrëveshje NIF ky transaksion rregjistrohet për shitjen si një detyrim për borxhmarresin dhe si një mëtej për blerësin (bankën ose investitorin e tjerë). Ripagimet rregjistrohen në mënyrë të ngjashme por me kah (drejtim) të

¹ NIF = lehtësi në emetimin e kambialeve.

kundert. Megjithate cdo pagese e lidhur me krijimin, shitjen dhe blerjen e NIF ose shitja e totalit te kambialeve te emetuara nga banka investitoreve te tjere rregjistrohet si nje *sherbim financiar* ne *llogarine kapitale*. Ashtu sikurse rekomandohet edhe per letrat e tjera te borxhit, skontimi ose premiot mbi kambialet e blera nga bankat ose investitoret e tjere (pervec pagesave te bera nga borxhmarresi per bankat), trajtohen si te ardhura nga interesi ose si te ardhura negative nga interesi respektivisht ne momentin e blerjes.

8.14 *Opsionet* jane kontrata qe i japin bleresit te opsionit te drejten por jo detyrimin te bleje (te kerkoje nje opsion) ose te shese (vendos nje opsion) nje instrument te vecante financiar ose mall me nje cmim te paravendosur, brenda nje harku kohor ose ne nje date te caktuar. Disa tipa te opsioneve jane ato ne monedha te huaja, normat e interesit, aksione, mallra etj. Bleresi i opsioneve i paguan nje premio (cmimi i opsioneve) shitesit (shkruesi ose emetuesi) per marreveshjen per te blere ose shitur shumen e percaktuar te instrumentit ose te mallit, ose per te siguruar me kerkesen e tij kompesimin perkates. Sipas ketij manuali kjo marreveshje eshte trajtuar si nje detyrim i shitesit dhe paraqet koston korrente me te cilen ballafaqohet shitesi per blerjen e ketij detyrimi te kushtezuar² .

8.15 Konceptualisht pagesa e premiove referuar asaj qe thame me lart perfshin dy elemente: (i) cmimin e blerjes se nje mjeti financiar, (ii) nje pagese sherbimi. Ne praktike shpesh nuk eshte e mundur te identifikohen elementet e sherbimit. Ne qofte se cmimi i sherbimit mund te vecohet ai duhet te rregjistrohet nen *sherbimet financiare*. Ne qofte se jo, rekomandohet qe premio e plote te rregjistrohet ne bilancin e pagesave si blerje e mjetit financiar nga bleresi dhe si nje shuarje e detyrimit per shitesin.

Tregtimi i metejshem (shitjet) e opsionit rregjistrohen ne *llogarine financiare* sipas rastit per shitjen ose blerjen e instrumentit financiar perkates. Ne qofte se opsioni ekzekutohet, blerja ose shitja e mjetit real ose financiar duhet te rregjistrohet me cmimin ekzistues te tregut ne komponentet perkates te bilancit te pagesave. Rregjistrimet balancuese jane shumate aktuale te marra ose te paguara; diferenca ndermjet kesaj shume dhe cmimit ekzistues te tregut reflektohet ne nje rregjistrim qe tregon shuarjen e opsionit. Kur parapagesat per nenshkrimin e nje opsioni paguhet nga pjesemarrësit ne opsion duhet te rregjistrohen si mjete dhe detyrime ne *llogarine financiare* nen *investime te tjera*, monedhe e depozita. Pagesat ne dhe terheqjet nga keto llogari mund te reflektohen ne transaksionet e tregtimit te opsioneve te cilave keto llogari u korrespondojne. Ne qofte keshtu, ato duhet te rregjistrohen ne transaksionet e *opsioneve* ne *llogarine financiare*.

8.16 *Garancite* (nje forme e vecante e opsionit) jane instrumenta te tregtueshem qe i japin zoteruesit te drejten te bleje nga emetuesi i garancive (zakonisht nje korporate) nje numer te caktuar aksionesh ose obligacionesh ne kushte te percaktuara per nje periudhe te percaktuar kohe. Garancite mund te tregtohen pamvaresisht nga letrat me vlere te lartpermendura (aksionet ose obligacionet) me te cilat ato jane te lidhura dhe si rrjedhim ato kane nje vlere tregu. Trajtimi i garancive eshte i njejte me ate te opsioneve te tjera dhe emetuesi i garancive konsiderohet se ka kryer nje detyrim qe perben anen e kundert te mjetit te zoteruar nga bleresi dhe paraqet koston korrente te blerjes se detyrimit te emetuesit.

8.17 Nje lloj tjetër i garancive te tregtueshme (zakonisht i emetuar nga ndermjetesit ne investime) eshte garancia per monedhat, vlere e te ciles bazohet ne sasine e nje monedhe te

² "detyrim i kushtezuar" nenkupton se ky detyrim do te lind nese bleresi i opsionit do te kerkonte ekzekutimin e marreveshjes

kerkuar per te blere nje monedhe tjeter ne/ose me pare se data e maturimit te garancise. Garancite e monedhave dhe garancite e monedhave te kryqezuara me pagesa te shprehura ne nje monedhe te trete do te trajtohet ne te njejten menyre si garancite e tjera.

8.17 *Marreveshja swap* eshte nje marreveshje kontraktuale, qe perfshin dy partnere te cilet bien dakort te kembejne pergjate kohes dhe sipas rregullave te paracaktuara, flukse pagesash ne te njejten shume me detyrimin sipas marreveshjes. Dy marreveshjet swap me te zakonshme jane swap-i per normat e interesit dhe swap-i per monedhat. Nje marreveshje swap per normat e interesit perfshin nje shkembim te pagesave per interesat e karaktereve te ndryshme (norma fikse dhe norma luhatese, dy normave luhatese te ndryshme, normave fikse ne nje monedhe dhe normave luhatese ne nje tjeter, etj). Nje marreveshje swap monedhash perfshin shkembimin e sasive te percaktuara te shprehura ne dy monedha te ndryshme dhe ripagesave te mevonshme qe reflektojne principalin dhe/ose interesin.

8.18 Rregjistrimet ne bilancin e pagesve per pagesat e interesave te shoqeruar me nje transakcion swap rregjistrohen neto ne *llogarine korrente*, dhe ripagesat e principalit e rregjistrohen ne *llogarine financiare*. Megjithese asnje nga pjesemarresit e marreveshjes swap nuk konsiderohet qe t'i siguroje sherbimin tjetrit, cdo pagese kundrejt nje pale te trete perfshire ne marreveshje rregjistrohet ne *sherbimet financiare*.

8.19 *Nje kontrate e tregtueshme e te ardhmes* eshte nje marreveshje midis dy paleve per te shkëmbyer nje mjet real per nje mjet financiar, ose te shkëmbejne ne nje date te caktuar me nje kurs te paracaktuar dy mjete financiare. Kontratat e tregtushme te se ardhmes perfshijne ato per normat e interesit, monedhat, mallrat, pasurite rregjistrohen ne llogarine financiare ashtu si dhe opsionet. Transaksionet e shoqeruara me kontratat e patregtueshme te se ardhmes ndeshen rralle dhe rregjistrohen nen mjete te tjera ose detyrime te tjera komponente te *investimeve te tjera*.

8.20 *Marrveshja e interesit forward (MIF)* eshte nje marrveshje sipas se ciles dy pale bien dakort te paguajne nje norme interesi ne nje date te percaktuar me marreveshje mbi nje sasi te supozuar principali qe nuk ndryshon kurre. Ne momentin e ekzekutimit te marreveshjes pagesa sipas kesaj marreveshje (p.sh. diferenca midis normes se interesit te marreveshjes dhe normes mbizoteruese ne treg) duhet te rregjistrohet si nje transakcion ne bilancin e pagesave. Bleresi i MIF-se arketon pagese nga shitesi ne qofte se norma e interesit mbizoterues eshte me e larte se ajo e percaktuar ne marreveshje; shitesi paguhet nga bleresi ne qofte se norma e interesit mbizorerues eshte me e ulet se ajo e percaktuar ne marreveshje. Keto pagesa rregjistrohen si te ardhura nga interesi ne *llogarine korrente* te bilancit te pagesave. Nuk ka rregjistrime ne *llogarine financiare* sepse kemi nje mjet te supozuar (jo real).

Vlersimi

8.21 Transaksionet ne zerat e investimeve te portofolit rregjistrohen me cmimet e tregut; cdo ndryshim ne vleren e tregut ndersa letrat me vlere jane akoma ne pronesi te zoteruesve (ndryshimet nga vleresimi) duhen perjashtuar. Transaksionet ne letrat me vlere zakonisht kryhen ne kushtet e nevojshme te vendosjes se cmimeve aktuale te tregut (p.sh. ne nje treg te organizuar), keshtu qe vlersimi i transakcioneve nuk ka te ngjare te sjelle ndonje shqetesim ne praktike. Megjithate eliminimi i vleresimeve nga ndryshimi i shumave te mbetura pezull eshte veshtire te kryhet ne praktike. Diferenca (d) ndermjet vleres se tregut te mjeteve pezull ne fillim dhe ne fund te periudhes mund te perfshijne (i) vleren e transakcionit te vleresuar me cmimin e tregut gjate

periudhes (vt), (ii) ndryshimet nga vleresimi te cilat duhen t'i zhvishen d-se per te marre vt qe duhet te rregjistrohet ne bilancin e pagesave.

8.22 Ndryshimet ne zoterimet e investimeve te portofolit te raportuar nga transaktoret ose agjentet e tyre (bankat, tregtaret e letrave me vlere, ndermjetesit etj) mund te perfshijne shuma per pagesat e sherbimit per transaksionin te cilat duhet te rregjistrohen ne sherbimet financiare.

Disa nga instrumentat e investimeve te portofolit.

Deftesat e Depozitave Amerikane

8.23 Nje deftese depozitimi amerikane eshte nje certifikate e negociueshme qe perfaqeson pronesine mbi letrat me vlere te nje kompanie jorezidente Amerikane. Megjithese keto lloj letrash mund te jene edhe instrumenta te borxhit ose te tregut monetar, ne pjesen dermuese ato jane letra me vlere te pasurise. Deftesat e depozitave amerikane lejojne nje kompani jorezidente ne Amerike te fuse pasurite e saj ne tregun amerikan ne nje forme shume me te pranueshme per investitoret amerikane pa u nevojitur i gjithë informacioni i kerkuar normalisht. Nje banke depozitimi Amerikane mund te bleje keto lloj letrash me vlere nga jorezidentet dhe me pas emeton deftesat ne dollare per keto letra me vlere per investitoret amerikane. Deftesat jane te rregjistruara. Investitoret mund te kembejne deftesat e tyre te depozimit me letrat me vlere ne cdo kohe.

Trajtimi sipas Bilancit te Pagesave

8.24 Cdo rast duhet trajtuar sipas llojit te instrumentit ne te cilin eshte investuar.

Fondet e investimeve

8.24 Jane nje strukture financiare nepermjet se ciles investitoret derdhin fondet e tyre per t'i investuar ne nje portofol te shumllojshem letrash me vlere. Investitoret individuale blejne aksione ne fond duke perfaqesuar interesin per pronesine e kesaj shporte mjetesh (letrash me vlere) domethene ato kane nje investim pasurie. Zgjedhja e mjeteve ku do te investohet behet nga drejtuesit e specializuar te ketyre fondeve. Si rrjedhim fondet e investimeve u japin investitoreve individuale mundesine te investojne ne nje portofol te shumllojshem letrash me vlere dhe njekohesisht te drejtuar, pa pasur nevojte per njohuri te detajuara mbi kompanite emetuese te aksioneve dhe obligacioneve.

Euroobligacionet

8.25 Jane letrat me vlere te shitura nga nje bashkim nderkombetar bankash dhe shtepish sigurimi investitoreve nderkombetare jashte tregut te brendshem te vendit te emetuesit. Keto lloj letrash me vlere i japin borxhmarresit nje numer dhe diversitet me te madh investitoresh sesa

mundesite qe ofrojne tregjet e brendshem, si rrjedhim rrisin likuiditetin dhe kane nje kosto me te ulet. Euroobligacionet kane nje larmishmeri jetgjatesie por zakonisht ato jane instrumenta afat-mesem dhe afat-gjate (3-20 vjet).

Zero kuponat

8.26 Jane letra me vlere te borxhit pa kupon ose me nje kupon shume here me te ulet se norma korrente e interesit. Keto obligacione emetohen me skontim kundrejt vleres se tyre nominale, skontimi reflekton normen e interesit mbizoteruese ne treg. Ne rastin e nje obligacioni me kupon zero investitori merr ne maturim diferencen ndermjet cmimit te blerjes dhe vleres nominale te obligacionit (te ashtuquajtur "uplift"). Sa me e madhe eshte jetegjatesia aq me i madh eshte skontimi kundrejt vleres nominale.

Trajtimi sipas Bilancit te Pagesave

8.27 Per qellime te bilancit te pagesave, diferenca ndermjet cmimit te emetimit dhe cmimit nominal te obligacioneve eshte trajtuar si e ardhur nga interesi dhe duhet te rregjistrohet per gjate gjithë jetes se obligacionit (si interes i perlllogaritur per periudhat perkatese).

Obligacionet e konvertueshme

8.28 Nje obligacion i konvertueshem eshte zakonisht obligacion me nje norme fikse i cili me kerkesen e investitorit mund te konvertohet ne kapital te borxhmarresit (me kerkesen e tij obligacion mbajtesi mund ta konvertoj obligacionin ne nje prej kapitaleve te coteruara nga emetesi i ketyre obligacioneve). Cmimi dhe kapitali ne te cilin obligacioni eshte i konvertueshem percaktohet qe ne momentin e emetimit dhe do te jete me nje premio kundrejt vleres se tregut per kapitalin ne momentin e emetimit. Mundesia e konvertimit qe jep obligacioni mund te ushtrohet ne nje date te caktuar ne te ardhmen ose brenda nje periudhe te caktuar kohe ne te ardhmen, qe quhet ("the window period"). E drejta e konvertimit nuk mund te shkeputet nga borxhi. Nje obligacion i konvertueshem zakonisht ka nje te ardhur me te larte se dividenti per te njejtin lloj kapitali ne momentin e emetimit por me te ulet se te ardhurat nga nje obligacion i ngjashem qe nuk e gezon mundesine e konvertimit.

Trajtimi sipas Bilancit te Pagesave

8.29 Manuali rekomandon te trajtohen ne instrumentat si kambiale dhe obligacione dhe mundesine e konvertimit si nje derivative financiare.

Letrat me vlere te garantuara nga mjetet

8.30 Keto jane obligacione te kolateralizuara nga mjete qe figurojne ne bilancin e emetuesit. Mjete specifike mund te sherbejne si kolateral per letrat me vlere dhe ne te njejtën kohe gjenerojne flukset e pagesave te cilat perdoren per te financuar pagesat e principaleve dhe interesave per investitorin. Nje leter me vlere e garantuar nga mjetet lejon institucionin kreditues fillestar t'i transmetojë riskun e kreditimit mbi investitorin.

Trajtimi sipas Bilancit te Pagesave

8.31 Keto lloje obligacionesh trajtohen si obligacione e kambiale.

Obligacionet e perjetshme

8.32 Keto instrumenta ne pergjithesi emetohen nga institucione financiare vecanerisht bankat. Ato jane te perjetshme dhe kane te njejten natyre si aksionet por dallojne prej tyre pasi ato jane instrumenta te borxhit. Meqenese kerkesa e investitoreve per obligacionet e perjetshme ka ardhur duke u dobesuar emetimet e fundit jane strukturuar aq sa per te siguruar likuiditetin ne treg.

Trajtimi sipas Bilancin e pagesave.

8.33 Trajtohen nen instrumentat si obligacione dhe kambiale.

Obligacionet Samuraj

8.34 Keto jane obligacione te huaja te hedhura ne tregun japonez te obligacioneve. Keto obligacione shprehen ne Jen.

Trajtimi sipas Bilancit te Pagesave

8.35 Trajtohen si obligacione dhe si kambiale.

Obligacionet e monedhave te dyfishta

8.36 Ky eshte nje variant i obligacioneve tradicionale. Obligacionet e monedhave te dyfishta mund t'i referohen strukturave te ndryshme te obligacioneve. Forma me e zakonshme eshte emetimi i nje obligacioni ne nje monedhe me pagesa kuponi ne te njejten monedhe por principalin ne nje monedhe tjeter. Kurset e kembimit per monedhat fiksohen ne momentin e emetimit te obligacionit. Obligacionet e monedhave te dyfishta tradicionalisht jane emetuar ne monedha me norma te uleta interesi dhe ripaguar ne Dollare Amerikan. Emetuesi do te kaloje nga monedha e emetimit ne monedhen e ripagimit per te arritur nje kosto te pergjithshme me te ulet dhe per te shmangur operacionet swap.

Trajtimi ne bilancin e pagesave

8.37 Sipas teorise ne momentin e maturimit duhet te behen dy rregjistrime qe i korrespondojne pageses se bere nga emetuesi. E para eshte e barabarte me vleren nominale te maturuar ne nje monedhe dhe te kthyer ne monedhen tjeter me kursin e kembimit ne treg; e dyta rregjisteohet si nje transaksion ne derivativat financiare dhe perfaqeson diferencen ne termat e monedhes se dyte ndermjet sasise me cmimin e tregut dhe asaj te paguar aktualisht. Ne praktike eshte rene dakort qe sasia e paguar ne maturim te klasifikohet si obligacione dhe kambiale.

Schuldscheine (shuldershaine)

8.38 Schuldscheine emetohen zakonisht nga ndermarjet e sektorit publik gjerman. Keto instrumenta jane dizenuar per nje shkalle te gjere investitoresh me nje minimum prej 1 milion DM per kambial dhe mund te kene nje jetegjatesi prej 10 ose me shume vjetesh. Ato nuk jane instrumenta te pagueshme dhe nuk kuotohen ne bursat e letrave me vlere. Megjithese schuldscheine nuk jane klasifikuar si letra me vlere nga ligji Gjerman, ato jane instrumenta te tregtueshem, por kane kufi per numrin e hereve qe ato mund te tregtohen. Meqenese schuldscheine jane quajtur ligjerisht hua, vlere e tyre nominale nuk bie madje edhe ne periudhat e rritjes se normave te interesit. Kur nje schuldscheine emetohet ne nje treg primar, huamarresi i

emeton nje certifikate (note) huadhenesit ku sqarohen hollesisht detajet e huase. Borxhmarresi ne kete rast rregjistron detajet e transaksionit. Ne rast se huadhenesi e shet kete instrument ne tregun sekondar, duhet te firmose nje note te shkruar per personin te cilit i ka shitur schuldscheine-en. Ky informacion i kalohet borxhmarresit dhe certifikata kalohet te bleresi. Kambialet blihen pa interesin e akumuluar, te cilat ndahen propocionalisht ne datat e pagimit te kuponave, per kedo qe zoteron kete instrument pergjate periudhes. Schuldscheine jane pergjthesisht te pasiguruara.

Trajtimi sipas Bilancit te Pagesave

8.39 Schuldscheine trajtohen si instrumenta borxhi dhe jane te negociueshem. Megjithese keto instrumenta demostrojne sebashku karakteristika te huase dhe letrave me vlere, Manuali sqaron se ne percaktimin e huave dokumentat ose intrumentat qe evidentojne nje hua jane te panegociueshme. Ne saje te natyres se tregtueshme te schuldscheine ato jane shmangur nga klasifikimi si nje hua ne kategorine *investime te tjera* dhe keshtu klasifikohen si letra me vlere ne *investimet e portofolit*.

INVESTIME TE TJERA

9.1 *Investime te tjera* eshte kategoria qe permbledh te gjitha transaksionet financiare qe nuk trajtohen nga *investimet direkte, investimet e portofolit ose mjetet e rezerves*.

Klasifikimi

9.2 Ashtu si ne rastin e *investimeve te portofolit* edhe investime te tjera klasifikohen fillimisht sipas llojit te instrumentit. Sektoret e brendshem sic jane autoritetet monetare, qeveria, bankat dhe sektore te tjere perbejne shkallen e dyte te klasifikimit. Ne dallim nga investimet direkte dhe investimet e portofolit, afati i maturimit - afatgjate apo afatshkurter - perben nivelin e trete te klasifikimit. Ne hartimin e bilancit tone te pagesave mbahet parasysh vetem kriteri i pare i klasifikimit.

9.3 Instrumentat sipas klasifikimit perfshijne huate (perfshire dhe perdorime kredish dhe huash nga Fondi), ripagimet, kredite tregtare, monedha dhe depozita, dhe mjete e detyrime te tjera. Ne bilancin Shqiptar te pagesave perdorim kredish dhe huash nga Fondi paraqitet si ze me vete.

Percaktimi dhe rregjistrimi

9.4 **Kredite tregtare** konsistojne ne detyrimet dhe pretendimet qe lindin nga kreditimi, (nga furnizuesit dhe bleresit), per transaksionet ne mallra dhe sherbime si dhe parapagesat per punimet ne proces (ose qe do te ndermerren) te lidhura me keto transaksione. (Huate per te financuar tregtine nuk perfshihen ketu sepse ato klasifikohen nen zerin *hua* shih paragrafin 8.5). Ne mungese te te dhenave per kredite tregtare, ato mund te vleresohen me diferencen ndermjet hyrjeve te rregjistruara per transaksionet ne mallra e sherbime dhe rregjistrimeve per pagesat perkatese te ketyre transaksioneve. Megjithese kredite tregtare dhe avancat kane natyre afatshkurter, ato ndahen ne kategori afatshkurter dhe afatgjate. Nje ndarje e tille nuk ndeshet ne

bilancin tone te pagesave. Nga ana tjetër kredite tregtare ne kete bilanc llogariten si nje perqindje e vleresuar e importeve ne kesh.

9.5 **Huamarrje shtetërore** perfshijne ato mjete financiare te krijuara permes huadhenies direkte te fondeve nga nje kreditor (huadhenesi) per nje debitor (huamarresi) mbi bazen e nje marreveshjeje ne te cilen huadhenesi ose nuk merr garanci qe te evidentojte transaksionin, ose merr nje dokument ose instrument te panegociueshem. Ketu perfshihen huate per financimin e tregtise, te tjera hua dhe avancat (perfshire dhe hipotekat), etj. Lizingu financiar dhe marreveshjet e riblerjes perfshihen gjithashtu ne zerin *hua*, megjithese nga pikpamja ligjore ato mund te mos trajtohen si hua.

Per evidentimin dhe llogaritjen e huave, sektori i bilancit te pagesave ka pergatitur nje formular te quajtur **Formulari Nr 12 per bilancin e pagesave**. Ky formular plotesohet nga bankat e nivelit te dyte, drejtoria e borxhit prane Ministrise se Financave dhe nga sektori i borxhit prane drejtorise se jashtme te Bankes se Shqiperise. Sic u permend edhe me lart ne bilancin tone *perdorim kredish dhe huash nga Fondi* del si ze me vete.

9.6 Huate afatgjata rregjistrohen bruto, zeri **ripagime** rregjistron ripagesat ose shlyerjet e principalit sipas dates se maturimit pavaresisht nga fakti nese behet apo jo pagesa ne kete date. Detyrimet qe maturohen dhe nuk shlyhen kalojne ne detyrimet e prapambetura duke shkaktuar nje rregjistrim me shenje negative ne zerin ripagime per shumen e pashlyer ne afat dhe nje rregjistrim ne: "***ndryshim ne detyrimet e prapambetura***" per te njejten shume me shenje pozitive. Rregjistrimi bruto per terheqjet dhe ripagimet siguron dhe nje informacion , qe mund te perdoret per analizat e borxhit dhe per te krahasuar te dhenat e bilancit te pagesave mbi borxhin me ato te burimeve te tjera te informacionit.

9.7 Manuali e trajton lizingun financiar si nje hua te mirfillte, ky trajtim mbeshetet ne supozimin se ne nje kontrate lizingu financiar pronesia e mallrave kalon nga qiradhenesi te qiramarresi. Lizingu financiar eshte nje menyre me te cilen qiramarresi financon blerjen e mallrave, ai sjell si pasoje nje pretendim financiar qe eshte nje mjet per qiradhenesin dhe nje detyrim per qiramarresin. Ne momentin e ndryshimit te pronesise se mallrave ne bilanc behen keto rregjistrime: vlera totale e mallrave rregjistrohet ne llogarine korrente, nje rregjistrim balancues behet ne llogarine financiare ne mjetet/detyrimet. Persa u perket pagesave te qirase ne periudhat pasardhese, ato ndahen ne interesa te cilat rregjistrohen ne llogarine korrente si te ardhura te pagueshme/te arketueshme dhe ripagimi i principalit (borxhit), i cili rregjistrohet ne llogarine financiare, duke reduktuar detyrimet e huamarresit dhe mjetet e huadhenesit.

9.8 **Perdorimi i kredive dhe huave nga Fondi**, perfshin livrimin e kredive nga Fondi, perjashtuar ketu perdorimet e transheve te pozicionit te rezerves se vendit anetar. Perdorimi i kredive dhe huave nga Fondi perfshin blerjet dhe huate nen mareveshjet stand-by apo marreveshje te tjera te rregullimit strukturor si S.A.F., E.S.A.F., ose hua Trust. Reduktimi i zoterimeve qe Fondi ka ne monedhen e nje vendi anetar, mbi kuoten e ketij vendi ne Fond minus pozicionin e transhit te rezerves, reflekton nje ripagim per zerin *perdorim kredish e huash nga Fondi* (shih: Pozicioni i Rezerves ne Fond, kap. Mjetet e Rezerves).

9.9 **Ndryshimet ne detyrimet/prendimet e prapambetura**¹ tregojne ndryshimin (rritjen ose pakesimin) ne te gjitha detyrimet e prapambetura karshi jorezidenteve (qofshin keto detyrime qe rrjedhin nga transaksionet korrente apo financiare).

9.10 **Monedha e depozita.** Monedhat konsistojne ne banknotat dhe monedhat qe jane ne qarkullim dhe qe perdoren per te kryer pagesat, (perjashtohen monedhat e vjetra dhe banknotat jashte qarkullimit). N.q.s. si monedhat e brendshme (detyrimet) te zoteruara nga jorezidentet, ashtu edhe ato te huaja (mjetet) te zoteruara nga rezidentet i sherbejne ketij qellimi, eshte mire qe ato te identifikohen vec si nje informacion suplementar.

Bazuar ne kete rekomandim, ne bilancin shqiptar te pagesave monedhat e depozitat rregjistrohen bruto.

9.11 Ne kategorine **depozita** perfshihen te gjitha llojet e depozitave, si ato *paafat* ashtu edhe ato *te tjera*. *Depozitat paafat* jane depozita te transferueshme me te pare, pa iu nenshtruar ndonje gjobe dhe qe transferohen lirisht me cdo lloj mjeti pagese. Depozitat mund te jene si ne monedhe vendi ashtu edhe ne valute. *Depozitat e tjera* perfshijne te gjithe pretendimet qe rrjedhin nga ekzistenca e depozitave pervec atyre paafat. Shembuj tipike jane depozitat e patransferueshme te kursimeve dhe depozitat me afat.

9.12 *Zerat monedha e depozita* ashtu dhe *depozita* trajtohen nga metodika jone e bilancit te pagesave ne perputhje te plote me Manualin e Bilancit te Pagesave. Burim i te dhenave per llogaritjen e ketyre zerave eshte Formulari Nr2 i bilancit te pagesave i cili plotesohet cdo muaj nga bankat tregtare. Ne kete formular paraqitet gjendja e depozitave nostro (mjeteve) dhe vostro (detyrimeve) ne fillim dhe ne fund te periudhes qe raportohet.

9.13 **Te tjera mjete/detyrime** mbulojne cdo element tjetër qe nuk perfshihet ne zerat e permendur me lart.

9.14 Burimi baze i informacionit per vleresimin e zerave te kategorise **investime te tjera** eshte sistemi bankar nepermjet formulareve Nr.1, Nr.2, Nr.3 per bilancin e pagesave, qe plotesohen perkatesisht dy te parete nga bankat e nivelit te dyte dhe i treti nga Banka e Shqiperise. Burim tjetër te dhenash eshte formulari Nr.14 per ndermarrjet jobankare.

¹ Detyrime/prendime te prapambetura quhen te gjitha ato detyrime/prendime te cilat nuk jane paguar/arketuar ne daten e maturimit.

MJETET E REZERVES

Konceptet dhe trajtimi

10.1 Mjetet e rezervës, përbejnë kategorinë e katert dhe të fundit të **llogarise financiare**. Rezervat janë një komponent i rëndësishëm i statistikave të bilancit të pagesave dhe një element thelbësor në analizen e pozicionit të jashtëm të një ekonomie. *Mjetet e rezervës* konsistojnë në ato mjete të jashtëme që janë menjëherë të përdorshme dhe kontrollohen nga autoritetet monetare për financimin direkt të cbalancimeve (deficiteve) në pagesa, për rregullimin indirekt të madhësisë së këtyre cbalancimeve nëpërmjet nderhyrjeve në tregjet valutore duke ndikuar mbi kursin e këmbimit të monedhës, dhe/ose për qëllime të tjera. Kategoria e *mjeteve të rezervës* në këtë *Manual* përfshin arin monetar, SDR-ne, pozicionin e rezervës në Fond, mjetet valutore (monedha dhe depozita dhe letra me vlerë), dhe pretendime të tjera. Ato letra me vlerë që nuk plotësojnë kërkesat e mjeteve të rezervës përfshihen në *investimet direkte* dhe *investimet e portofolit*.

Identifikimi i mjeteve të rezervës

10.2 Karakteristikat e dukshme të një pretendimi siç janë: pronësia ligjore, tregtueshmëria, emertimi i monedhës, afati i maturimit etj, nuk janë të mjaftueshme për të përcaktuar nëse një pretendim është aktualisht i vlefshëm për tu përdorur nga autoritetet monetare për qëllimet e përmendura më lart. Megjithatë, duhet theksuar që mjete të rezervës gjithmone u referohen atyre mjeteve që ekzistojnë realisht. Pretendimet që mund të lindin si rezultat i marrëveshjeve që kanë hyrë në fuqi p.sh., mjetet valutore të *siguruara* nën një marrëveshje "swap" apo linja të tjera krediti, ose nëpërmjet përdorimit të kredive nga Fondi nën një marrëveshje stand-by nuk përbejnë pretendime reale, pra dhe mjete rezerve.

Kontrolli efektiv

10.3 Aspekti i kontrollit mund të cmohet vetëm duke iu referuar koncepteve institucionale në ekonomitë individuale. Në kuptimin më të ngushtë, autoritetet monetare kontrollojnë absolutisht vetëm ato mjete për të cilat ato zotërojnë tituj ligjorisht. Në kuptimin e gjërë, pothuaj çdo mjet i zotëruar nga një rezident i ekonomisë mund të jetë subjekt i këtij kontrolli. Asnjëri prej rasteve ekstreme të përmendura më lart nuk është subjekt i bilancit të pagesave. Koncepti i mjeteve të

rezerves duhet te përfshije ato mjete mbi të cilat autoritetet ushtrojnë një kontroll direkt dhe efektiv. Pronesia e mjeteve financiare nuk përben një kusht të domosdoshëm për kontrollin e tyre. Për shembull, nëse bankat zoterojnë tituj legale mbi mjetet valutore, por lejohen t'i përdorin këto mjete vetëm sipas rregullave të përcaktuara nga autoritetet monetare, ose vetëm me aprovimin e tyre të shprehur, këto mjete do të konsideroheshin subjekte të kontrollit efektiv dhe direkt të këtyre autoriteteve.

Vlefshmeria për përdorim.

10.4 Fakti nëse mjetet e kontrolluara nga autoritetet monetare janë të gatshme për përdorim në raste nevojë, varet pjesërisht nga kushtet e vendosura mbi këto mjete, kryesisht nga likuiditeti ose tregtueshmëria e mjetit. Mjetet në zotërim (ari monetar, SDR, pozicioni i rezerves në fond), që janë menjëherë të vlefshme mund të shihen si mjete në formën më të pakushtëzuar. Mjetet valutore dhe pretendime të tjera, në më të shumtën e rasteve, janë të barasvlerëshme.

Perjashtimi i ndryshimeve nga vlerësimi dhe rregullime të tjera

10.5 Edicioni i pestë i Manualit të Bilancit të Pagesave, përjashton të gjitha ndryshimet e mjeteve të rezerves të cilat nuk janë pasoje të transaksioneve. Kështu ndryshimet në vlerë që rezultojnë nga fluktuacionet në cmimet e *mjeteve të rezerves*, ndryshime që janë shoqëruar me krijimin e mjeteve të rezerves (monetarizimi ose demonetarizimi i arit dhe akordimi apo shuarja e SDR) dhe kundërbalancueset e këtyre ndryshimeve nuk rregjistrohen në evidencat e bilancit të pagesave. Gjithashtu përjashtohen dhe nuk rregjistrohen në bilanc ndryshimet nga riklasifikimi.

Klasifikimi

10.6 **Ari monetar** është ari i zotëruar nga autoritetet monetare (ose që ndodhet nën kontrollin efektiv të tyre) dhe që mbahet me cilesinë e mjetit të rezerves. Pjesa tjetër e arit (*ari jomonetar*) pavaresisht nga pronesia trajtohet si të gjithë mallrat e tjera. **Transaksione në ar monetar ndodhin vetëm midis autoriteteve monetare dhe analogeve të tyre në ekonomitë e tjera, ose midis autoriteteve monetare dhe organizatave nderkombëtare.** Ashtu si dhe SDR, ari monetar është një mjet rezerve mbi të cilin nuk ekziston asnjë detyrim financiar.

10.7 Autoritetet që i shtojnë zotërimet e tyre të arit monetar nëpërmjet blerjes së arit monetar (ar i ri i nxjerrë ose ar ekzistues i ofruar në tregun privat) ose që e qarkullojnë arin monetar nga zotërimet e tyre për qëllime jomonetare (për shitje zotëruar apo përdoruesve private) kanë monetarizuar ose demonetarizuar arin. Cdo rritje apo zvogëlim në zotërimet e arit monetar që rezultojnë nga monetarizimi apo demonetarizimi trajtohet si riklasifikim i arit; një rritje apo zvogëlim i tillë nuk tregohet në bilancin e pagesave por në pozicionin nderkombëtar të investimeve. Nëse ari (flitet për arin monetar) blihet nga/i shitet një jorzidenti çfarëdo atëherë ky transaksion do të rregjistrohet si një import/eksport në kategorinë *mallra* në **llogarinë korrente** dhe në **llogarinë financiare**, si një kredi/debi në zërin financiar që është përdorur/marre për të financuar këto import/eksport.

Te drejtat speciale te terheqjes (SDR)

10.8 SDR jane mjete te rezerves te krijuara nga Fondi Monetar Nderkombetar per te plotesuar mjetet e tjera te rezerves qe u jane akorduar periodikisht anetareve te Fondit Monetar Nderkombetar, ne perpjesetim me kuotat e tyre respektive. SDR nuk konsiderohen detyrime ndaj Fondit dhe akordimi i saj nuk mbart mbi vete detyrimin per ripagimin e SDR-se se akorduar. Midis transakcioneve te tjera, SDR mund te perdoret per te fituar monedha te vendeve te tjera antare te Fondi Monetar Nderkombetar (valute e huaj), per te huajtur obligacione financiare, dhe si kolateral per zgjerimin e huamarrjeve. Ndryshimet ne SDR te autoriteteve monetare mund te lindin nepermjet: i. transakcioneve qe perfshijne pagesa ose terheqje te SDR-se ne Fond, pjesemarrsve te tjere ne Departamentin e SDR-se ne Fond, apo zoteruesve te tjere te SDR, ose ii. akordimit apo shuarjes se tyre.

Transaksionet si ato te permendura ne piken i. perfshihen ne bilancin e pagesave ndersa akordimi apo shuarja e SDR-se nuk rregjistrohet ne kete bilanc por reflektohet ne pozicionin nderkombetar te investimeve.

Pozicioni i rezerves ne Fond

10.9 Nje anetar i Fondi Monetar Nderkombetar mund te kete ne Llogarine e Burimeve te Pergjithshme te Fondit, nje *pozicion* i cili rregjistrohet ne kategorine e ***mjeteve te rezerves***, ky pozicion i referohet perkatesisht **pozicionit te rezervave ne Fond**. Pozicioni i rezervave te anetareve eshte shuma e blerjeve te transhit te rezerves qe nje anetar mund te terheqe dhe cdo detyrimi te Fondit (nen nje marreveshje huaje) qe eshte menjehere i ripagueshem anetarit. Blerjet e transheve te rezervave jane blerje ne Fond te monedhave te tjera deri ne ate mase sa zoterimet e fondit ne monedhen e vendit perkates te mos e tejkalojne kuoten e tij ne Fond (minus zoterimet qe reflektojne perdorime kredish nga Fondi).

Cdo shtet qe pranohet si anetar i ri i Fondit Monetar Nderkombetar duhet te derdhe ne Fond nje kuote te caktuar. Nder te tjera kjo kuote percakton fuqine votuese te cdo anetari dhe sasine e burimeve te Fondit qe ky vend mund te zoteroje potencialisht. Kuota per cdo anetar, percaktohet duke marre ne konsiderate nje numer treguesish ekonomike te vendit anetar sic jane GDP-ja, rezervat dhe niveli i tregtise se jashtme. Kjo kuote shprehet ne SDR, qe eshte njesia e llogaritjes per te gjitha llogarite e Fondit.

*Cdo anetari i kerkohet qe te paguaje 25 perqind te kuotes se tij ne nje monedhe te pranueshme nga Fondi (monedhat e forta si UDS, DEM etj), te ndryshme nga monedha e tij kombetare. Ne cdo rast, ky 25 perqindesh do te paguhet ne nje monedhe plotesisht te konvertueshme. Ky 25 perqindesh percakton vleren fillestare te **pozicionit te rezerves ne Fond** per cdo anetar, dhe eshte pjese perberese e **rezervave** te tij. Ne bilancin e pagesave ne kete rast do te kete rritje ne "pozicionin e rezerves ne Fond" (debi). Ky 25 perqindesh i kuotes njihet gjithashtu si **transhi i rezerves** se nje vendi.*

Nje blerje nga Fondi, rregjistrohet si nje rritje ne zoterimet e mjeteve valutore dhe nje pakesim ne pozicionin e rezerves ne Fond; nje riblerje e bere nga Fondi do te rregjistrohet si nje pakesim dhe nje rritje perkatesisht ne zoterimet e mjeteve valutore dhe pozicionit te rezerves ne Fond. Blerjet

ne transhet e rezervave nuk konsiderohen si perdorim kredish nga Fondi, nuk jane subjekt pagesash dhe nuk kerkojne keshtu riblerje. Cdo terheqje qe ben nje anetaret i Fondit (pervec atyre kundrejt pozicionit te tij te transhit te rezerves) perben nje perdorim kredish nga Fondi.

10.10 **Mjetet valutore** perfshijne pretendimet e autoriteteve monetare ndaj jorezidenteve ne formen e monedhave, ECU, depozitave bankare, letrave me vlere te qeverise, obligacioneve, kambialeve, instrumentave monetare, derivateve financiare, letrave me vlere te kapitalit, dhe pretendimeve te patregtueshme qe lindin si rrjedhoje e marreveshjeve ndermjet bankave qendrore ose qeverive. (Valuta e huaj mbulon ato pretendime qe tregohen si komponente te valutes se huaj te serive per likuiditetin nderkombetar te publikuar nga Fondi ne Statistikat Financare Nderkombetare.)

Vleresimi

10.11 Ne parim, te gjitha transaksionet e mjeteve te rezerves rregjistrohen me cmimin e tregut- qe eshte, kursi i kembimit ne kohen e kryerjes se transaksionit, cmimet e tregut per pretendimet si letrat me vlere dhe kursi i tregut per SDR-ne. Transaksionet ne arin monetar duhet te vleresohen gjithashtu me cmimin mbisundues te tregut.

Si burim informacioni per llogaritjen e ndryshimeve ne mjetet e rezerves sherben formulari Nr 3 per Banken e Shqiperise, ky formular plotesohet nga Departamenti i Jashtem ne Banken e Shqiperise me frekuence mujore.